

# MANUAL MBI PËRFSHIRJEN E TË RINJVE

Projekti:

**“CONNECTED: BUILDING  
BRIDGES, CREATING FUTURES”**

British Council Albania dhe  
Agjencia Kombëtare e Rinisë

*Ky botim u realizua me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) dhe British Council. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e AKR-së dhe British Council.*

*Ky projekt financohet nga Programi i Rrugëve Alternative, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatuar nga Zyra e Këshillit Britanik në Shqipëri.*

2024

## **Tabela e përmbledhjes**

|  |    |
|--|----|
| <b>I. HYRJE</b> .....  | 7  |
| <b>II. KORNIZAT LIGJORE, POLITIKAT DHE STANDARDET PËR Pjesëmarrjen e të Rinjve</b> .....                           | 10 |
| 2.1 Kornizat Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen Rinore.....  | 10 |
| 2.2. Legjislacioni Shqiptar për Pjesëmarrjen e të Rinjve.....  | 12 |
| <b>III. STRUKTURA RINORE DHE Pjesëmarrja e të Rinjve në Vendimmarrje</b> .....                                     | 21 |
| <b>IV. ANALIZA E SITUATËS DHE NEVOJAVE TË TË Rinjve për Pjesëmarrje</b> .....                                      | 26 |
| 4.1 Analiza cilësore .....   | 27 |
| 4.2 Analiza sasiore.....   | 31 |
| <b>V. METODA DHE METODOLOGJI TË PROPOZUARA TË Rritjes së Përfshirjes së të Rinjve në Komunitetet e Tyre:</b> ..... | 37 |
| 5.1 Rëndësia e qytetarisë aktive dhe përfshirjes së të rinjve në vendimmarrjet e komunitetit të tyre.....          | 37 |
| 5.2 Teori dhe modele të angazhimit efektiv të të rinjve .....  | 39 |
| <b>VI. PËRFSHIRJA E TË Rinjve në Procese Votuese</b> .....   | 50 |
| 6.1 Format e pjesëmarrjes së të rinjve në politikë. ....   | 51 |
| 6.2 Mënyrat e ndryshme të vendimmarrjes në një Demokraci .....   | 52 |
| 6.3 Cfarë duhet të dimë para zgjedhjeve për Kuvendin? .....  | 54 |
| <b>VII. RASTE STUDIMORE DHE USHTRIME</b> .....   | 56 |
| <b>Struktura e Lojës:</b> .....  | 62 |
| 1. Përgatitja.....   | 62 |
| 2. Hapat e Lojës .....   | 63 |
| Rezultatet e pritshme .....  | 64 |

|   |           |
|---|-----------|
| <b>Bibliografi</b> .....  | 66        |
| <b>SHTOJCA 1</b> .....  | 69        |
| Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve ..... | <b>69</b> |

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

AKR - Agjencia Kombëtare e Rinisë

AMSHC - Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile

KKR - Këshilli Kombëtar Rinor

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KVR - Këshilli Vendor Rinor

MSHRF - Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

NJVV - Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

OECD - Organisation for Economic Co-operation and Development

OSBE - Organisation for Security and Cooperation in Europe

OJF - Organizata Jo Fitimprurëse

OSHC - Organizata të Shoqërisë Civile

OZHQ - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

PBA - Projektbuxhet Afatmesëm

SKR - Strategjia Kombëtare e Rinisë

VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave



# I. HYRJJE

Rinia përfaqëson një shtyllë të rëndësishme të zhvillimit shoqëror, duke qenë njëkohësisht burim energjie, inovacioni dhe ndryshimi. Trendet globale dinamike dhe zhvillimet politike aktuale, të karakterizuara nga transformimet teknologjike, ndryshimet klimatike, dhe sfidat gjeopolitike, kërkojnë një angazhim të shtuar nga të gjitha grupet e interesit. Në këtë kontekst, të rinjtë luajnë një rol kyç si motorë të inovacionit, ndryshimit dhe advokimit për një të ardhme më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Duke qenë më të ndjeshëm ndaj çështjeve si barazia sociale, mjedisi dhe teknologjitë e reja, të rinjtë sjellin perspektiva të reja në proceset vendimmarrëse, në shumë nivele. Është e rëndësishme që ata të fuqizohen për të marrë pjesë aktive në formulimin dhe zbatimin e politikave, duke shndërruar energjinë dhe vizionin e tyre në zgjidhje konkrete për sfidat globale. Sipas INSTAT, në Shqipëri, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç, zënë rreth 22.7% të popullsisë<sup>1</sup>. Kjo pjesë e rëndësishme e popullsisë, gjithnjë e më tepër ka nevojë për vëmendje nga të gjithë institucionet për të reflektuar nevojat, sfidat dhe potencialin e tyre për të sjellë zhvillim në vend.

Përgatitja e një manuali mbi përfshirjen e të rinjve është një proces i rëndësishëm për të promovuar pjesëmarrjen aktive të tyre në vendimmarrje, zhvillimin e komuniteteve ku banojnë, pjesëmarrjen në aktivitete sociale e për rrjedhojë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Një sërë kornizash ligjore ndërkombëtare e kombëtare mbështesin këtë aspekt të aktivizimit rinor dhe gjithashtu një sërë programesh e projektsh janë zbatuar e zbatohen në këtë drejtim nga aktorë të

---

<sup>1</sup> <https://www.instat.gov.al/al/statistika-zyrtare-femije-dhe-te-rinj/popullsia/t%C3%AB-rinj-15-29-vje%C3%A7-n%C3%AB-raport-me-popullsin%C3%AB/>.

ndryshëm. Megjithatë, realiteti tregon se të rinjtë shqiptarë kanë nevojë për një udhërrëfyes lidhur me përfaqësimin rinor dhe sesi zëri i tyre të mund të dëgjohet në çdo nivel vendimmarrjeje.

Koncepti i përfshirjes është një koncept i gjerë i cili ka në bazë përfshirjen aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe në proceset demokratike, politikëbërëse, sociale dhe ekonomike, me fokus fuqizimin e tyre si individë, por që gjithashtu ndihmon në krijimin e një shoqërie më të drejtë, gjithë përfshirëse dhe të qëndrueshme. Ligji i Rinisë 75/2019 dhe Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2209, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 692, datë 26.10.2022, shërbejnë si bazat kryesore për politikën në lidhje me aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve.

Sfidat me të cilat ndeshen të rinjtë në Shqipëri janë të shumta, duke theksuar kryesisht në punësim, reflektuar në normat e larta të papunësisë, pasivitetin dhe papunësinë afatgjatë. Shkalla e papunësisë për moshat 15-29 vjeç ishte 22.5% në vitin 2022, dyfishi i përqindjes së papunësisë së popullsisë së përgjithshme në moshë pune, me një hendek të konsiderueshëm gjinor prej 16% (INSTAT, AFP 2022). Po ashtu, shkalla e të rinjve që nuk janë as në arsim, as në punësim, dhe as në trajnim (NEET) ishte 25.2% në vitin 2022, më shumë se dyfishi i mesatares së BE-27 prej 11.7%. Së fundmi në Shqipëri janë vënë re edhe tendenca migruese të të rinjve shqiptarë duke reflektuar sfida sociale dhe ekonomike të vendit. Arsye kryesore për emigrimin përfshijnë kërkimin për mundësi më të mira punësimi, arsimim cilësor dhe një standard jetese më të lartë. Për adresimin e këtij problemi, është e domosdoshme të krijohen politika që mbështesin rininë, përmes investimeve në arsim, hapjes së vendeve të punës dhe promovimit të një mjedisi tërheqës ekonomik dhe social që nxit qëndrueshmërinë dhe dhënien fuqi të zërit të tyre në aspektin politik dhe ekonomik.

Këto statistika dhe të dhëna orientojnë në domosdoshmërinë e krijimit dhe zbatimit të politikave për të adresuar problematikat e të rinjve, ku ata vetë janë pjesë të këtyre proceseve. Të rinjtë mund dhe duhet të luajnë një rol kyç në nxitjen e politikave më inovative dhe të përqëndruara në nevojat e tyre. Pjesëmarrja aktive në organizata rinore, debate politike, procese votuese dhe lëvizje shoqërore është thelbësore për krijimin e një baze të fuqishme demokratike në vend. Për një ndikim të qëndrueshëm, nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse që përfshin bashkëpunimin midis institucioneve shtetërore qendrore e lokale, shoqërisë civile dhe vetë të rinjve. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e një shoqërie ku të rinjtë ndihen të dëgjuar dhe të fuqizuar.

Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë udhëzime praktike për institucionet, individët dhe organizatat që dëshirojnë të promovojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen aktive të të rinjve. Duke i pajisur me mjete dhe njohuri të nevojshme, manuali synon të krijojë një kornizë të qartë dhe efektive për përfshirjen e të rinjve në çdo aspekt të jetës demokratike, shoqërore e ekonomike.

Ky manual bazohet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe në parimin se përfshirja e të rinjve nuk është vetëm një e drejtë, por edhe një mundësi për të nxitur ndryshime pozitive. Fokus i veçantë i jepet përfshirjes së të rinjve në proceset votuese dhe kryesisht ata që janë votues për herë të parë. Nëpërmjet këtij dokumenti, ne synojmë të ndërgjegjësojmë të gjithë aktorët për rëndësinë e angazhimit rinor dhe të ofrojmë shembuj konkretë të praktikave më të mira për zbatimin e tyre.

Le të punojmë së bashku për të ndërtuar një të ardhme ku zërat dhe idetë e të rinjve janë në qendër të vendimmarrjes!

## **II. KORNIZAT LIGJORE, POLITIKAT DHE STANDARDET PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE**

### **2.1 Kornizat Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen Rinore**

Kuadri rregullator lidhur me përfshirjen e të rinjve, është e bazuar në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut përfaqësojnë liritë dhe të drejtat bazë që i përkasin secilit individ, nga lindja deri në vdekje, si dhe përbëjnë themelin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Aktivizimi dhe përfshirja e të rinjve përmendet në minimalisht gjashtë Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), si vijon: Zero uri, arsim cilësor, barazi gjinore, punë të denjë dhe rritje ekonomike, pabarazi të reduktuara dhe veprim klimatike.

Përfshirja e të rinjve është një element thelbësorë në promovimin e të drejtës së tyre për të formuar mendime, për t'i shprehur ato dhe për të kontribuar aktivisht në jetën publike dhe politike. Referuar praktikave ndërkombëtare, të drejtat e njeriut mbështeten nga një seri traktatesh dhe konventash ndërkombëtare, si:

- Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që garanton lirinë e shprehjes.
- Neni 11 dhe Neni 3 (Protokolli Nr. 1) i Konventës Evropiane, që mbrojnë të drejtën për pjesëmarrje në jetën demokratike dhe qytetare.
- Neni 12 i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), që mbron të drejtën e fëmijëve nën moshën 18 vjeç për t'u dëgjuar dhe për të pasur pikëpamjet e tyre të konsideruara.

Po ashtu ekzistojnë edhe konventa të tjera ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e grupeve të caktuara, si Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara etj.

Përfshirja e të rinjve u mundëson atyre të zhvillojnë aftësi për të ndikuar pozitivisht në komunitetet e tyre. Siç përmendet në Preambulën e Kartës së Rishikuar Evropiane mbi Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale: "Përfshirja në jetën demokratike të çdo komuniteti përfshin më shumë se votimin apo kandidimin në zgjedhje. Ajo nënkupton të pasurit të drejtën, mjetet, hapësirën dhe mundësinë për të ndikuar në vendimet dhe për të marrë pjesë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë."

Në Evropë, ekzistojnë një sërë iniciativash dhe dokumentesh që mbështesin dhe promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike dhe qytetare. Këto përfshijnë:

- *Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.* Komiteti i Ministrave ka lëshuar disa rekomandime për shtetet anëtare, të cilat përfshijnë: Pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike, përfshirjen në jetën lokale dhe rajonale, mbështetjen e shoqërisë civile rinore, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve nën 18 vjeç etj.
- *Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027.* Kjo strategji synon të nxisë angazhimin social dhe qytetar të të rinjve, duke siguruar që ata të kenë burimet e nevojshme për të marrë pjesë në shoqëri. Strategjia thekson: Të gjitha politikat që lidhen me të rinjtë duhet të mbrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave që ndikojnë tek ata; Përfshirjen domethënëse të organizatave rinore.
- *Neni 6 i Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë (ERYICA),* e cila përfshin: Pjesëmarrjen e të rinjve në krijimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e informacionit rinor, platforma që mundësojnë

aktivitete bashkëmoshatare, nxitjen e të rinjve për të dhënë komente si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm të shërbimeve të informacionit për ta.

- *Strategjia Eurodesk 2022-2027*, e cila synon të rrisë përfshirjen e të rinjve në konsultimet dhe proceset publike të BE-së, përfshirë Dialogun Rinor. Programet e lëvizshmërisë mësimore si Erasmus+, Korpusi Evropian i Solidaritetit dhe të tjera.
- *Karta Evropiane e rishikuar për Pjesëmarrjen e të Rinjve në jetën Lokale dhe Rajonale*, e miratuar në maj 2003 nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, u krijua për të mbështetur dhe forcuar pjesëmarrjen e të rinjve si bazë e një shoqërie demokratike.
- *Politikat Kombëtare dhe Programet Lokale* për secilin shtet anëtar ose që adrean të bëhet pjesë e BE-së.

Këto politika dhe standarde përbëjnë një bazë të fuqishme për të garantuar pjesëmarrjen aktive të të rinjve në shoqëri dhe për të mbështetur zhvillimin e tyre si qytetarë aktivë.

## **2.2. Legjislacioni Shqiptar për Pjesëmarrjen e të Rinjve**

Në Shqipëri, përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse mbështetet nga një sërë kornizash ligjore, dokumentash strategjike kombëtare, institucionesh, strukturash e politikash të dedikuara për fuqizimin e rinisë, duke krijuar kështu një bazë të mirë për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve. Përvec konventave ndërkombëtare që gjejnë zbatim edhe në territorin tonë, vlejnë të përmenden rregullimet ligjore kombëtare si më poshtë vijon:

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, garanton të drejtën e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike për të gjithë qytetarët, duke përfshirë të rinjtë. Në Nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë parashikohet mbrojtje e veçantë për të rinjtë, ku theksohet se: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti.” Të drejtat e të rinjve janë të garantuara në kuadrin e të drejtave dhe lirive të njeriut që përcakton Kushtetuta, si dhe në bazë të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë,” i cili siguron një themel ligjor për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë dhe veprimtarinë e Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF).

Institucioni i Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar në **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 524 dt 22.09.2021 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”** harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirëedukimin e fëmijëve.

**Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”**, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2019, shënoi një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kuadrit ligjor për mbështetjen dhe zhvillimin e të rinjve në Shqipëri. Ky ligj synon të forcojë mundësitë për aktivizim, bashkëpunim institucional dhe financim publik në mbështetje të interesave rinore në fusha të ndryshme sociale, ekonomike dhe kulturore. Ai institucionalizon ndërveprimin me të rinjtë, rregullon format e angazhimit të tyre dhe promovon rolin e tyre si aktorë ndryshimi. Gjatë hartimit të ligjit, u referuan praktikat e vendeve si Bullgaria dhe Serbia, përfshirë modelin e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore dhe standardet e saj në përfaqësim dhe mbulim territorial.

Në nenin 1, të Ligjit **Nr. 75/2019 “Për rininë”**, specifikohen parimet për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve, si vijon:

Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme:

a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi; 2 b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve; c) parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave; ç) parimin e subsidiaritetit.

Ligji prezanton koncepte kyçe si edukimi joformal, i cili përfshin aktivitete jashtë sistemit arsimor të bazuara në vullnetarizëm dhe pjesëmarrje aktive, si dhe dialogu i strukturuar mes të rinjve dhe institucioneve shtetërore, duke promovuar një bashkëpunim transparent dhe afatgjatë. Gjithashtu, ai përqendrohet në krijimin e hapësirave të sigurta rinore, me fokus në sigurinë fizike, por pa adresuar mjaftueshëm aspektet digjitale dhe sociale të këtyre hapësirave.

Janë specifikuar aspekte të *Ligjit Nr. 75/2019 “Për rininë”*, me anë të Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM), si vijon:

- VKM Nr. 681, datë 2.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”. Ky vendim përcakton rolin e AKR-së në koordinimin e politikave rinore dhe mbështetjen e të rinjve në fusha të ndryshme.
- VKM Nr. 969, datë 2.12.2020 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të

Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij. Ky vendim specifikon kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, i cili funksionon si një organ këshillimor për çështjet rinore në nivel kombëtar.

- VKM Nr. 274, datë 12.05.2021 “Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR)”. Ky vendim adreson mënyrën e krijimit të OKPR-së, kriteret e përfaqësimit dhe mbulimin territorial. Bazuar në pikën 1 të kësaj VKM, përcaktohet qëllimi i këtij vendimi, i cili është rregullimi i kriterëve dhe standardeve që duhet të plotësojë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR) për të siguruar përfaqësimin e interesave të rinjve në nivel kombëtar. Ky vendim adreson bazën ligjore për krijimin dhe funksionimin e OKPR-së, duke synuar garantimin e përfaqësimit të drejtë dhe gjithëpërfshirës të organizatave rinore dhe individëve në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- VKM Nr. 833, datë 24.12.2021 “Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”, si një bazë e të dhënave për organizatat rinore dhe/pse për të rinjtë, në mbështetje të zhvillimit të tyre dhe rritjes së transparencës, informimit dhe për rrjedhojë edhe përfshirjes së të rinjve.
- VKM Nr. 658, datë 29.10.2021 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe Organizatave për të Rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë.”, lidhur me përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve rinore nga fondet publike, duke synuar mbështetjen e organizatave rinore dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet sociale, kulturore dhe ekonomike.

Këto VKM synojnë të operacionalizojnë dispozitat e ligjit, duke krijuar strukturat dhe mekanizma për mbështetjen dhe përfshirjen aktive të të rinjve në shoqëri.

**Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 dhe Plani i saj i Veprimit**, është dokumenti kryesor që përcakton politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve në Shqipëri. E miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022, kjo strategji mbulon periudhën 2022-2029 dhe mbështetet mbi një bazë të fortë ligjore dhe kushtetuese. Në Nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet mbrojtje e veçantë për të rinjtë, ku theksohet se: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti.” Të drejtat e të rinjve janë të garantuara në kuadrin e të drejtave dhe lirive të njeriut që përcakton Kushtetuta, si dhe në bazë të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë,” i cili siguron një themel ligjor për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë dhe veprimtarinë e Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF). Përveç bazës kushtetuese dhe ligjore, SKR 2022-2029 është hartuar në bashkëpunim me grupin e punës ndërministror dhe reflekton disa dokumente të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto përfshijnë Programin e Qeverisë 2021-2025, Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027, dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Këto referenca synojnë të integrojnë prioritetet kombëtare me objektivat evropiane dhe globale për rininë, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 (SKR) është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke theksuar në mënyrë të veçantë rolin aktiv të të rinjve në përcaktimin e prioritetëve dhe objektivave të saj. Përveç koordinimit me ministrinë e linjës,

institucionet e varësisë, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët ndërkombëtarë, një fokus i veçantë iu kushtua konsultimit të drejtpërdrejtë me të rinjtë në të gjithë vendin.

SKR është përmendur shpesh për metodologjinë gjithëpërfshirëse që ka përdorur për krijimin e saj. Gjatë periudhës së draftimit, të rinjtë nga e gjithë Shqipëria u bënë pjesë në konsultime të hapura, ku ngritën shqetësimet dhe sfidat që përballojnë, si dhe propozuan ide dhe zgjidhje konkrete për t'i adresuar ato. Ky proces jo vetëm që garantoi përfaqësimin e mendimeve të tyre, por gjithashtu i bëri të rinjtë bashkautorë në hartimin e strategjisë. Idetë dhe sugjerimet e tyre u integruan si elementë thelbësorë të SKR 2022-2029, duke e bërë atë një dokument që reflekton realitetet dhe aspiratat e brezit të ri. Përmes këtij angazhimi, strategjia synon të adresojë në mënyrë efektive nevojat dhe potencialin e të rinjve, duke i fuqizuar ata si aktorë kyç në zhvillimin e vendit.

SKR 2022 – 2029 synon realizimin e tre qëllimeve politike, si vijon, ku vihet re një rol i drejtpërdrejtë dhe një qëllim i posacëm lidhur me fuqizimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve, konkretisht në qëllimin e parë<sup>2</sup>.

Qëllimi politik 1: Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

Qëllimi politik 2: Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes

---

<sup>2</sup> <https://riniafemijet.gov.al/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miratuar/>

edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Qëllimi politik 3: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.

Gjithashtu në kuadër të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, si pjesë e **kapitullit 26 “Arsimi dhe Kultura”** është edhe rinia. Gjatë prezantimit të raportit screening në vitin 2023, u shënuar progresi që kishte bërë Shqipëria në fushën e edukimit, trajnimit, rinisë sportit dhe kulturës. Acquis përbëhet kryesisht nga Rekomandimet e Këshillit në një sërë fushash që lidhen me shkollën, arsimin profesional, të lartë dhe të të rriturve, vullnetarizmin e të rinjve dhe lëvizshmërinë e tyre. Vlen të theksohet që Strategjia Kombëtare e Rinisë, është e linjësuar me Strategjinë Europiane të Rinisë 2019-2027. Shqipëria ka përfituar nga programe si Erasmus+, Korpusi Evropian i Solidaritetit dhe iniciativa të tjera që promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në projekte ndërkombëtare dhe vendimmarrje.

**CDEJ-** Shqipëria është përfaqësuese e Komitetit Drejtues Evropian për Rininë (CDEJ). CDEJ u krijua nga Komiteti i Ministrave sipas nenit 17 të Statutit të Këshillit të Evropës dhe funksionon në përputhje me Rezolutën CM/Res(2021)3 për komitetet ndërqeveritare dhe organet vartëse, termat e tyre të referencës dhe metodat e punës. (CDEJ) mbledh së bashku përfaqësues të ministrive ose organeve përgjegjëse për çështjet rinore nga 48 Shtetet Palë të Konventës Kulturore Evropiane. CDEJ nxit bashkëpunimin ndërmjet qeverive në sektorin e rinisë dhe ofron një kornizë për krahasimin e politikave kombëtare për rininë, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe hartimin e teksteve të përcaktimit të standardeve.

**Ligji Nr. 10 093, datë 9.3.2009**, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" (AMSHC), përcakton rolin e kësaj agjencie si një mekanizëm për mbështetjen financiare dhe organizative të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Ky ligj thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, përfshirë edhe organizatat rinore, në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimin e politikave publike. AMSHC ka për detyrë të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), duke përfshirë organizatat rinore, në konsultimet për politikat publike dhe në vendimmarrjen që ndikon në sektorin e shoqërisë civile dhe komunitetin në përgjithësi. Përmes fondeve që administron, AMSHC mbështet nisma që promovojnë pjesëmarrjen qytetare, përfshirjen rinore dhe angazhimin e grupeve të ndryshme sociale në çështjet publike. Ligji kërkon që procedurat e AMSHC të jenë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar që të gjitha grupet e interesit, përfshirë të rinjtë, të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga mbështetja. Së fundmi, AMSHC nxit përfshirjen e OSHC-ve në konsultime për hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare, duke krijuar hapësira për pjesëmarrjen e organizatave rinore në proceset strategjike.

Nga pikëpamja legjislative, përveç Ligjit 75/2019 ku përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e Vetëqeverisjes vendore, janë minimalisht edhe dy ligje që priorizojnë çështjet rinore.

**Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, rinia bëhet pjesë e përgjegjësisë dhe prioritet për NjVQ për funksione që i kanë kaluar pushtetit vendor. Ndonëse nuk flitet në mënyrë eksplicite për rininë, Neni 23 përcakton funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike ku bëjnë pjesë mirëmbajtja e institucioneve arsimore apo Neni 25, ku

përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. Neni 16 i këtij ligji garanton pjesëmarrjen publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes dhe ngritja e Këshillave Rinor Vendor do t'i jepte një zë në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëmarrjes së të rinjve.

**Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, neni 38, pika 2, fq. 16 duhet të mbështeti iniciativat planifikuese buxhetore për të rehat dhe të rinjtë në linjë me nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjike të hartuar për këtë qëllim

Gjithashtu, referuar grupmoshës së rinisë, në Shqipëri ka edhe një sërë dokumentesh shtetërore strategjike dhe programore të cilët adresojnë prioritetet e të rinjve lidhur me fuqizimin dhe përfshirjen e tyre si:

- Programi i Qeverisë 2021-2025, Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025,
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe plani i veprimit,
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 dhe plani i veprimit,
- Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030 dhe plani i veprimit,
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030 dhe plani i veprimit,
- Strategjia Ndersektoriale e Drejtësisë për të Mitur dhe Planin i veprimit 2022–2026,
- Planin Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2019-2023,

- Dokumenti Strategjik dhe Plan i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021,
- Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, etj.

Këto korniza dhe mekanizma përbëjnë një bazë të rëndësishme për fuqizimin e të rinjve në Shqipëri dhe përfshirjen e tyre aktive në zhvillimin shoqëror dhe politik.

### **III. STRUKTURA RINORE DHE PJESËMARRJA E TË RINJVE NË VENDIMMARRJE**

**Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët**, krijuar me Vendim Nr. 524, Datë 22.9.2021 “*Për Përcaktimin E Fushës Së Përgjegjësisë Shtetërore Të Ministrit Të Shtetit Për Rininë Dhe Fëmijët*”, ka në bazë të misionit dhe përgjegjësisë shtetërore hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe miredukimin e fëmijëve. Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton, zhvillon dhe monitoron politikat, për: a) mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; b) krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve; c) përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për çështjet e rinisë; ç) bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë; d) të rinjtë shqiptarë në diasporë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën; dh) programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

Ligji Nr. 75/2019 , gjithashtu parashikon ngritjen e disa strukturave kryesore të cilat kanë patur një impakt domethënës në rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në të gjithë vendin: **Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR)**, e cila ka zëvendësuar Shërbimin Kombëtar Rinor; **Këshillin Kombëtar të Rinisë**, si organ këshillimor në nivel kombëtar; **Këshillin Vendor të Rinisë**, që funksionon pranë bashkive; dhe **Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR)**, si një Organizatë ombrellë për përfaqësimin e të rinjve. Megjithëse zbatimi i objektivave të ligjit është përshpejtuar vitet e fundit, disa elementë të tij mbeten ende pjesërisht ose plotësisht të pazbatuar, duke kërkuar përpjekje të mëtejshme për realizimin e plotë të tij.

**Agjencia Kombëtare e Rinisë**, krijuar në bazë të Vendimit Nr. 681, Datë 2.9.2020 *“Për Mënyrën E Krijimit, Të Organizimit E Të Funksionimit Të Agjencisë Kombëtare Të Rinisë (AKR)”*, ka në bazë të përgjegjësiwe funksionale të saj, të organizojë veprimtarinë për: a) realizimin e funksioneve që lidhen me mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve; b) sigurimin e kushteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e të rinjve nga subjekte vendase ose të huaja; c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut të strukturuar, për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri; ç) krijimin e mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.

Organizatata e shoqërisë civile vlerësohen si aktorë të rëndësishëm, të cilët, përmes veprimtarive të tyre në komunitet, luajnë një rol kyç në rritjen e përfaqësimit, mbrojtjes dhe zhvillimit të interesave të të rinjve, duke plotësuar shpeshherë kapacitetet e institucioneve shtetërore. Ligji nr. 75/2019 *“Për Rininë”* e formalizon këtë rol duke

parashikuar dy lloje organizatash jo-fitimprurëse: **organizatat rinore dhe organizata për të rinjtë**, të cilat janë OJF me në fokus aktivitete për të rinjtë, si dhe duke u krijuar mundësi për financim përmes granteve shtetërore për rininë.

**Këshilli Kombëtar Rinor**, sipas nenit 4 të Ligjit për Rininë, 75/2019, është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme: a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë; b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve; c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj; ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve. 2. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë. 3. Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Këshilli Vendor Rinor**, sipas nenit 10 të Ligjit për Rininë, 75/2019, është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme: a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë; b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor; 5 c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë; ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të

Rinisë. 2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë. 3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kritereve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

“Manuali për ngritjen e këshillave vendor pranë Bashkive”, u krijuar fillimisht nga rrjeti POP dhe Olof Palm në bashkëpunim me MSHRF dhe AKR. Sot në Shqipëri numërohen 61 KVR të ngritura dhe trajnimi i vazhdueshëm e rritja e kapaciteteve të këtyrë aëtarëve është thelbësore për rritjen e ndikimit dhe efektivitetit të Këshillave Vendorë të Rinisë. Pjesëmarrja e të rinjve në këtë organ këshillimor kërkon zhvillimin e aftësive jetësore dhe të lidershipit.

**Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)** është një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i themeluar nga pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor 6 (BB 6): Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, që synon të promovojë frymën e pajtimit dhe bashkëpunimi mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit të të rinjve. Marrëveshja për Themelimin e RYCO u nënshkrua nga kryeministrat e 6 të BB-së në Samitin e BB-së të mbajtur në Paris, më 4 korrik 2016.

**Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor** është një nismë 3 vjeçare që implementohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) me mbështetjen e Bashkimit Evropian (EU). Kjo iniciativë është e para në llojin e saj në Ballkan dhe synon të bëjë bashkë përfaqësuesit e

institucioneve, shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të përshtatshëm në krijimin e përbashkët të politikave publike me fokus rininë, dialogun dhe bashkëpunimin institucional. Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor është një iniciativë që përfshin të gjashta vendet e Ballkanit: Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova\*, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Me fokus tek punësimi rinor, kjo iniciativë është bashkërenduar me të gjitha ministritë e linjës dhe organizatat rinore më përfaqësues në secilën prej ekonomive me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen e përbashkët të problematikave kryesore që shqetësojnë të rinjtë.

**Këshillat e Studentëve** janë pjesë e institucioneve të arsimit të lartë dhe kanë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve për studentët. Ato mund të formohen në nivel fakulteti, universiteti ose dhe më gjerë, dhe përfaqësojnë studentët në takime me administratën dhe organet vendimmarrëse. Këto struktura janë të rëndësishme për zhvillimin e politikave rinore dhe pjesëmarrjen e studentëve në proceset e menaxhimit të jetës universitare. Në shumë universitete shqiptare, këshillat e studentëve janë të njohura dhe funksionojnë si një element i domosdoshëm për përfaqësimin e interesave të studentëve dhe organizimin e aktiviteteve që kanë ndikim në jetën akademike dhe sociale të tyre.

**Grupet Joformale të të Rinjve** janë grupe që formohen dhe funksionojnë pa një strukturë formale, rregulla të rrepta, ose regjistrime zyrtare. Ato shpesh janë të drejtuara nga interesat e përbashkëta të individëve dhe mund të jenë shumë të ndryshme në natyrën dhe qëllimin e tyre. Disa shembuj të grupeve joformale mund të përfshijnë grupe rinore që merren me aktivitete sociale, kulturore, sportive, apo edukative, pa qenë të lidhura drejtpërdrejt me institucione të formalizuara si shkolla apo organizata rinore. Në Shqipëri, grupet joformale janë gjithashtu një mundësi për të rinjtë të

merren me aktivitete që nuk kërkojnë një angazhim të madh dhe që janë të hapura për të gjithë ata që janë të interesuar. Ato mund të shërbejnë si urë lidhëse mes rinisë dhe institucioneve të tjera shoqërore, duke krijuar mundësi të tjera për përfshirje dhe angazhim. Ndërsa ato mund të krijojnë mundësi për zhvillim personal dhe shoqëror, një sfidë mund të jetë mungesa e mbështetjes institucionale dhe mundësive për t'u financuar, krahasuar me grupet formale.

#### **IV. ANALIZA E SITUATËS DHE NEVOJAVE TË TË RINJVE PËR PJESËMARRJE**

Qeveria e Shqipërisë e konsideron rininë një faktor kyç për zhvillimin e vendit, duke e vendosur atë në qendër të strategjive të saj për zhvillim. Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tij kanë krijuar një kornizë të plotë ligjore dhe institucionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve shqiptarë, si dhe për përmirësimin e ekosistemit rinor në vend. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029, së bashku me planin e saj të veprimit, synon të integrojë çështjet rinore në sektorët dhe politikat e ndryshme shtetërore, ndërkohe që një nga 3 qëllimet politike të këtij dokumenti adreson posacërisht fuqizimin e të rinjve në të gjitha nivelet e tyre të pjesëmarrjes.

Për hartimin e këtij manuali dhe për të realizuar përmbushjen e qëllimit të këtij botimi, kemi përzgjedhur një **përqsje metodologjike të përzier**. Është realizuar një analizë cilësore e raporteve të situatës së të rinjve në vend, si raporte monitorimi të dokumenteve të

ndryshme strategjike, analiza të ndryshme, raporte të institucioneve të pavarura, por gjithashtu edhe anketime me grupe të rinjve.

## **4.1 Analiza cilësore**

Çështjet e lidhura me grupmoshën e rinisë, nevojat, prioritetet dhe problematikat e tyre, adresohen në mënyrë të përditshme nga një sërë dokumentesh politikë strategjike dhe programore si vijon: Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe plani i saj i veprimit, Programi i Qeverisë 2021-2025, Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe plani i veprimit, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 dhe plani i veprimit, Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030 dhe plani i veprimit, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030 dhe plani i veprimit, Strategjia Ndersektoriale e Drejtësisë për të Mitur dhe Plan i veprimit 2022–2026, Planit Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2019-2023, Dokumenti Strategjik dhe Plan i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021, Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm si dhe përmes shqyrtimit të dokumenteve të tjera orientuese dhe të vlerësimit të institucioneve ndërkombëtare si Strategjia e Rinisë së Bashkimit Evropian, Strategjinë e Rinisë së Këshillit të Evropës dhe Progres Raporti i Komisionit Evropian për Vitin 2024.

Regjistrimi neto në arsimin e mesëm të lartë mbetet një sfidë, me një nivel prej vetëm 76.2%, shumë më i ulët se mesatarja e BE-së. Gjithashtu, pjesëmarrja në programet e arsimit profesional për vitin akademik 2022-2023 ishte e ulët, duke përfshirë vetëm 17.5% të grupit përkatës të moshës. Në përputhje me angazhimet e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të krijuar një treg pune të qëndrueshëm dhe për të rritur përfshirjen e të rinjve të moshës 15-29 vjeç, Shqipëria ka hartuar dhe miratuar Planin e Zbatimit të Garancisë për Rininë (YGIP)

2023-2024. Ky plan synon të rrisë punësimin e të rinjve që aktualisht nuk janë të angazhuar në punësim, arsim ose trajnim (NEET).

Organizatat e shoqërisë civile vlerësohen si aktorë të rëndësishëm, të cilët, përmes veprimtarive të tyre në komunitet, luajnë një rol kyç në rritjen e përfaqësimit, mbrojtjes dhe zhvillimit të interesave të të rinjve, duke plotësuar shpeshherë kapacitetet e institucioneve shtetërore. Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë” e formalizon këtë rol duke parashikuar dy lloje organizatash jo-fitimprurëse: organizatat rinore dhe ato që punojnë për të rinjtë, si dhe duke u krijuar mundësi për financim përmes granteve shtetërore për rininë.

Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik, në raportin e saj specifikon që Shqipëria ka bërë progress të moderuar drejt arritjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 gjatë vlerësimit të bërë për vitin 2023.

Në vijim, OECD analizon që qeveria ka integruar objektivat globalë të zhvillimit të qëndrueshëm në agjendat kombëtare dhe sektoriale por progresi mbetet i dobët për shkak të mos mbështetjes së mjaftueshme me buxhet<sup>3</sup>. Sipas këtij raporti, progresi ekonomik dhe përfshirja mbeten të kufizuara nga mungesa e aksesit në burimet financiare në të gjithë popullsinë, papunësia e lartë e të rinjve dhe mungesa e të drejtave themelore të të punësuarëve.

Rinia, përmes energjisë, ideve novatore, forcës për ndryshim është konsideruar gjithmonë si e ardhmja e një vendi. Për këtë arsye, investimi në përmirësimin e situatës së të rinjve mbetet një investim afatgjatë për çdo shoqëri në tërësi. Qeveritë shqiptare përgjatë

---

<sup>3</sup> <https://monitor.al/oecd-shqiperia-eshte-perkeqesuar-ne-28-te-objektivave-te-zhvillimit-2030-arsimi-me-renien-me-te-madhe/>

tranzicionit kanë dëshmuar gatishmëri të ulët për zbatimin e plotë të ligjeve të miratuara, kryesisht prej mungesës së vullnetit dhe mos plotësimit të mekanizmave nënligjore dhe sigurimit të buxhetit të nevojshëm. Për më tepër legjislacioni në fushën e rinisë është vlerësuar si i vakët dhe i mangët, madje shpesh herë edhe i pazbatueshëm<sup>4</sup>.

Teksa Shqipëria vijon procesin e zhvillimit dhe integritit, shoqëria ndikohet domosdoshmërisht nga ndryshimet globale dhe rajonale. Të rinjtë, që gjenden në fazën e kalimit nga fëmijëria në moshën madhore ose në fillimet e pavarësisë së tyre jetësore, janë veçanërisht të prekshëm, pasi ende nuk kanë siguruar një bazë të fortë ekonomike dhe sociale. Në këtë kontekst, shteti ka përgjegjësinë të krijojë politika efektive dhe mekanizma mbështetës për të garantuar mbrojtjen, fuqizimin, zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen aktive të të rinjve në vendimmarrjet dhe proceset që ndikojnë në të ardhmen e tyre. Në këtë kuadër, nevoja për aktivizimin, fuqizimin e të rinjve dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarëse është më e domosdoshme se kurrë.

Miratimi i Ligjit për Rininë hapi rrugën për krijimin e strukturave konsultative të dedikuara, si Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe Këshillat Vendorë të Rinisë, me qëllim garantimin e një angazhimi më të madh të të rinjve në hartimin dhe zbatimin e politikave rinore.

Këshilli Kombëtar i Rinisë u krijua në vitin 2021 dhe ka funksionuar në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar. Paralelisht, ngritja e Këshillave Vendorë Rinor në 61 bashkitë e vendit ka qenë një prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHRF) dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR).

---

<sup>4</sup> Peçi D. & Xhemollari R., “Analysis of the youth policies at the central level” 2020

Me ngritjen dhe konsolidimin e të gjithë Këshillave Vendorë të Rinisë dhe punësimin e specialistëve rinorë në bashki, fokusi tani është zhvendosur drejt fuqizimit të këtyre strukturave. Gjatë dy viteve të fundit, MSHRF dhe AKR kanë organizuar aktivitete për rritjen e kapaciteteve të tyre. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për ta kthyer këto struktura në mekanizma të efektshëm për zhvillimin dhe zbatimin e politikave rinore në nivel lokal.

Një nga sfidat kryesore mbetet mungesa e informacionit të të rinjve mbi instrumentet në dispozicion të tyre, gjë që ndikon negativisht në përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse, sidomos në bashkitë e vogla dhe zonat rurale. Përveç fuqizimit të kapaciteteve të këtyre strukturave, është e domosdoshme të rritet ndërgjegjësimi dhe qasja e të rinjve ndaj këtyre mekanizmave për të siguruar një angazhim më të gjerë dhe të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre, janë ndër aktorët më të përshtatshëm për të informuar, trajnuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse. Përveç kësaj, ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në aktivizimin dhe aftësimin e të rinjve për të ndërmarrë nisma konkrete që adresojnë sfidat e komunitetit të tyre, duke u kthyer në shembull pozitiv për bashkëmoshatarët.

Ndërkohë, Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 ka si objektiv specifik përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta dhe miqësore. Ajo thekson rëndësinë e ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike si biblioteka, qendra rinore, parqe dhe hapësira rekreative, duke krijuar ambiente të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë. Këto hapësira synohen të shërbejnë si bazë për të nxitur veprimtarinë rinore, ndërveprimin social dhe kulturor, vetëshprehjen dhe zhvillimin e punës rinore.


Strategjia e konsideron qendrat rinore si një platformë kyçe për fuqizimin e të rinjve në nivel lokal, duke mbështetur krijimin e tyre në të gjithë vendin, përfshirë çdo bashki. Këto qendra janë projektuar për të përmbushur nevojat e të rinjve, duke u ofruar atyre mundësi për angazhim aktiv dhe zhvillim personal.

Në këtë kuadër, Agjencia Kombëtare e Rinisë, përmes thirrjeve për projektpropozime, ka financuar rikonstruksionin, ndërtimin dhe vënien në funksion të qendrave rinore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke kontribuar në rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve për të rinjtë.


Përfshirja e të rinjve ka të bëjë me masat që u japin individëve dhe grupeve në mënyrë që të kenë qasje në shërbimet publike dhe të marrin pjesë me shkallën më të lartë të aftësive të tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të shoqërisë. Në Shqipëri vihet re një dizbalancë e madhe midis mundësive, shërbimeve, aktiviteteve etj. që përfitojnë të rinjtë e kryeqytetit në krahasim me të rinjtë që jetojnë jashtë tij. Për këtë arsye, përfshirja sociale duhet të ketë në qendër të nismave reduktimin e pabarazive dhe promovimin e përfshirjes për të gjithë të rinjtë që jetojnë në njësitë administrative të qeverisjes vendore. Këto nisma duhet të kenë në fokus edhe nevojat e disa grupimeve si: persona me aftësi të kufizuara, komuniteti rom e egjiptian, të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social apo personave të tjera nga grupe të disavantazuara.

## **4.2 Analiza sasiore**

Pjesëmarrja gjinore në këtë anketim ndahet në 65% vajza dhe 35% djem, ndërkohë që vendbanimi i referohet si zonave urbane ashtu edhe atyre rurale. Referuar statusit të tyre, target grupet kanë variuar nga nxënës/student, deri në ato në marrëdhënie pune apo të papunë, si vijon:




Pyetjes, se *“Sa të përfshirë ndiheni në aktivitetet komunitare ose sociale në zonën tuaj?”*, ata ju përgjigjën si vijon, duke treguar domosdoshmërinë e adresimit të këtij shqetësimi të të rinjve:




Rezultati që tregon se një pjesë e madhe e të anketurëve nuk janë të përfshirë ose janë pak të përfshirë në aktivitetet komunitare ose sociale në zonën e tyre tregon një mungesë funksionimi të angazhimit qytetar në komunitete e tyre dhe mund të vijë si rrjedhojë e disa faktorëve si:

Mungesa e informacionit dhe aksesit, mungesatë organizatave rinore, niveli i ulët i motivimit personal për të marrë pjesë, mungesa e njohurive të duhura etj. Pavarësisht arsyes, ky rezultat tregon se është e nevojshme që të punohet më shumë për të krijuar mundësi, motivim dhe mbështetje për të rinjtë që të bëhen më të angazhuar në aktivitete që përmirësojnë jetën e tyre dhe të komunitetit në përgjithësi.

Ndërsa pyetjes se **“Çfarë pengesash keni hasur për t’u përfshirë në aktivitete të ndryshme?”**, 32.8% ju përgjigjën që pengesa kryesore vinte nga mungesa e informacionit, ndërkohë që pjesa tjetër, të shpërndarë midis kohës së kufizuar, mbështetjes së pamjaftueshme apo burimeve financiare të kufizuara.



Nga pyetja që vijon, **“A mendoni se ka mjaftueshëm mundësi për të rinjtë në komunitetin tuaj për përfshirje?”**, rezultatet tregojnë një perceptim të qartë të mungesës së mundësive nga ana e të rinjve në komunitet. Evidentohet një përqindje të lartë të të rinjve, të cilët janë të bindur që nuk ka mjaftueshëm mundësi për ta në komunitetet ku jetojnë (49.2%), pasuar me (27.9%) nga ata të cilët nuk kanë mjaftueshëm informacion dhe kanë preferuar përgjigjen që “Nuk jam i/e sigurt”



**49.2% “Jo”**, është një përqindje e lartë që sugjeron se gati gjysma e të rinjve ndihen të përjashtuar ose nuk e shohin komunitetin e tyre si një mjedis që ofron hapësira dhe mundësi për përfshirje aktive. Kjo mund të lidhet me mungesën e qendrave rinore, aktiviteteve kulturore, sportive apo edukuese, ose me mospërputhjen e mundësive ekzistuese me nevojat dhe interesat e të rinjve.

**23% “Po”**. Ky grup tregon një perceptim pozitiv, por relativisht të ulët. Vetëm një në katër të rinj mendon se ka mjaftueshëm mundësi për përfshirje. Kjo sugjeron që, edhe pse mund të ketë disa nisma dhe hapësira për të rinjtë, ato nuk janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse ose nuk arrijnë të adresojnë nevojat e shumicës.

**28% “Nuk jam i sigurt”**. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve nuk kanë një mendim të qartë mbi mundësitë për përfshirje. Kjo mund të nënkuptojë mungesë informacioni mbi iniciativat ekzistuese, distancim nga proceset vendimmarrëse ose një indiferencë të krijuar për shkak të përvojave të mëparshme. Ky grup përfaqëson një

potencial të paeksploruar që mund të përfitojë nga ndërgjegjësimi dhe përfshirja aktive përmes politikave dhe programeve rinore.

Gjithashtu, të rinjtë, pyetjes se “**Cilat fusha ju interesojnë më shumë për t’u përfshirë**” ata ju pergjigjen me fushat si vijon: Edukimi dhe trajnimet, Sportet dhe aktivitetet fizike, Artet dhe kultura, Aktivizmi social dhe mjedisor, Teknologjia dhe inovacioni, Sipërmarrja dhe karriera.

*Përfundime dhe rekomandime të analizës sasiore:*

Mungesa e mundësive (49%) dhe pasiguria (28%) tregojnë nevojën për të përmirësuar ofertën e aktiviteteve dhe infrastrukturës për të rinjtë. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të hapësirave sociale dhe kulturore, përfshirjes në procese vendimmarrëse dhe zhvillimit të programeve që adresojnë nevojat specifike të të rinjve.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i iniciativave ekzistuese është jetike për të arritur te grupi që nuk është i sigurt. Një analizë më e thellë mbi arsyet që ndikojnë në perceptimin negativ të 49% të të rinjve do të ndihmonte në dizajnimin e politikave më efektive për ta ndryshuar këtë situatë.

Ndërsa përgjigjet që theksojnë interesat kryesore të të rinjve në fusha si Edukimi dhe trajnimet, Sportet dhe aktivitetet fizike, Artet dhe kultura, Aktivizmi social dhe mjedisor, Teknologjia dhe inovacioni, si dhe Sipërmarrja dhe karriera, ofrojnë një pasqyrë të qartë të prioriteteve të tyre në lidhje me përfshirjen komunitare dhe sociale. Këto fusha reflektojnë interesat e diversifikuara të të rinjve dhe tregojnë se:

- *Edukimi dhe trajnimet* janë thelbësore për zhvillimin personal dhe profesional, duke treguar një përqendrim në përgatitjen për të ardhmen.
- *Sporet dhe aktivitetet fizike* reflektojnë rëndësinë e mirëqenies fizike dhe sociale për këtë grup.
- *Artet dhe kultura* theksojnë nevojën për shprehje krijuese dhe eksplorimin e identitetit kulturor.
- *Aktivizmi social dhe mjedisor* shpreh një ndërgjegje të lartë për çështje globale dhe vendore, duke treguar një angazhim për ndryshime pozitive.
- *Teknologjia dhe inovacioni* tregojnë interesin e të rinjve për të qenë pjesë e zhvillimeve bashkëkohore dhe për t'u përfshirë në një botë të ndërlidhur dixhitale.
- *Sipërmarrja dhe karriera* reflektojnë ambicien dhe dëshirën për vetë-zhvillim dhe sukses ekonomik.

Këto preferenca ofrojnë udhëzime të vlefshme për vendimmarrësit dhe organizatat për të krijuar programe që u përgjigjen interesave të ndryshme të të rinjve dhe për të rritur përfshirjen e tyre aktive në aktivitete komunitare dhe sociale.

## **V. METODA DHE METODOLOGJI TË PROPOZUARA TË RRIJES SË PËRFSHIRJES SË TË RINJVE NË KOMUNITETET E TYRE:**

### **5.1 Rëndësia e qytetarisë aktive dhe përfshirjes së të rinjve në vendimmarrjet e komunitetit të tyre**

Qytetaria aktive dhe pjesëmarrja e të rinjve në komunitet janë elementë thelbësorë për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe demokratike. Përfshirja e të rinjve në jetën e komunitetit kontribuon në fuqizimin e tyre si individë dhe si grupime, ndërsa ndihmon edhe në zhvillimin e komunitetit dhe shoqërisë në tërësi. Disa nga aspektet që nënvizojnë rëndësinë e qytetarisë aktive dhe angazhimit rinor janë:

- *Fuqizimi personal dhe zhvillimi i aftësive*

Pjesëmarrja aktive ndihmon të rinjtë të zhvillojnë aftësi të rëndësishme si mendimi kritik, komunikimi, puna në grup dhe udhëheqja. Përmes angazhimit në aktivitete komunitare, ata fitojnë përvoja praktike që i ndihmojnë të jenë më të përgatitur për sfidat e jetës dhe të tregut të punës.

- *Ndikimi në vendimmarrje dhe politika*

Të rinjtë, duke qenë një grup dinamik dhe krijues, sjellin ide të reja dhe perspektiva novatore në proceset vendimmarrëse. Përfshirja e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave publike siguron që nevojat dhe interesat e tyre të merren parasysh në mënyrë më të plotë.

- *Përmirësimi i komunitetit*

Përfshirja rinore ndihmon në identifikimin dhe adresimin e problemeve lokale, si mjedisi, arsimit, shëndetësia apo barazia

sociale. Të rinjtë që marrin pjesë në projekte komunitare kontribuojnë në krijimin e një mjedisi më të mirë për veten dhe të tjerët.

- *Rritja e ndjenjës së përkatësisë*

Kur të rinjtë marrin pjesë aktivisht, ata ndihen më të lidhur me komunitetin dhe shoqërinë e tyre. Kjo ndjenjë përkatësie ndihmon në uljen e izolimit social dhe krijon një brez të ri qytetarësh të angazhuar.

*Nxitja e demokracisë dhe qëndrueshmërisë sociale*

Qytetaria aktive i edukon të rinjtë me vlera demokratike si solidariteti, toleranca dhe bashkëpunimi. Përmes pjesëmarrjes, të rinjtë mësojnë rëndësinë e përgjegjësisë sociale dhe zhvillojnë vetëdijen për të drejtat dhe detyrimet e tyre si qytetarë.

*Model pozitiv për bashkëmoshatarët dhe ndërtimi i një të ardhmeje më të mirë*

Të rinjtë që janë aktivë në komunitet shërbejnë si modele për bashkëmoshatarët, duke i inkurajuar ata të ndjekin shembullin dhe të angazhohen. Pjesëmarrja e të rinjve në çështjet e komunitetit siguron që zërat e tyre të dëgjohen dhe sfidat e tyre të adresohen, duke ndërtuar një bazë më të fortë për brezat e ardhshëm dhe janë kyçe për zhvillimin e një shoqërie të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Rëndësia e qytetarisë aktive dhe pjesëmarrjes së të rinjve në komunitetin, fshatin apo bashkinë ku jetojnë jepet qartë në manualin e Këshillit të Evropës “Have your say”: “Pjesëmarrja e një komuniteti në jetën demokratike nënkupton diçka më tepër se votimi ose kandidimi në zgjedhje, edhe pse këto janë elemente të rëndësishme të pjesëmarrjes. Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive nënkupton të kesh të drejtë, mjete, hapësirë, mundësi dhe aty ku është e nevojshme, mbështetje për të marrë pjesë, për të ndikuar në vendimmarrje si dhe

për t'u angazhuar në veprime dhe aktivitete për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë.”<sup>5</sup>

Një gamë e gjerë aktivitetesth mund të klasifikohen si qytetari aktive, dhe ato kontribuojnë së bashku në ndërtimin e një demokracie gjithëpërfshirëse. Këto aktivitete përfshijnë votimin dhe kandidimin në zgjedhje, mësimdhënien dhe të nxënit, dhurimin për qëllime të mira, riciklimin dhe kujdesin për mjedisin, fushatat e advokimit dhe vullnetarizmin. Këto nisma mund të zhvillohen në nivele të ndryshme, si ato profesionale, politike ose personale.

## **5.2 Teori dhe modele të angazhimit efektiv të të rinjve**

Teoritë e pjesëmarrjes së komunitetit kanë tërhequr një vëmendje në rritje të akademikëve veçanërisht në fillim të viteve 1990, ndërsa debati për këtë ka nisur prej viteve 1960. Në të njëjtën linjë qëndrojnë edhe studiuesit postmodernistë Sherry Arnstein (1969) dhe Roger Hart (1997), si dy artikulimet më të famshme dhe serioze në drejtim të pjesëmarrjes komunitare dhe rinore me shkallën e pjesëmarrjes, të cilët akoma më shumë bëjnë dallimin e konceptit të pjesëmarrjes edhe më të thelluar se Pateman specifikisht në kontekstin politik. Shkalla e Pjesëmarrjes, trajtuar dhe zhvilluar nga këta studiues, përmban tetë hapa dhe përfaqëson nivelet në rritje të pjesëmarrjes rinore në forma të ndryshme bashkëpunimi me të rriturit.

Roger **Hart**, në studimin e tij për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete shoqërore dhe zhvillimin e komunitetit, ka identifikuar

---

<sup>5</sup> <https://rm.coe.int/have-your-say-manual-alb/168072a389> Fjalën e ke ti është një doracak për Kartën e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonal


tetë shkallë të pjesëmarrjes, të cilat janë të ndara në një hierarki që varion nga aktivitetet e detyruara deri tek ato që fëmijët dhe të rinjtë kanë kontroll të plotë mbi to, si vijon:

- I. Manipulimi: Aktivitetet ku fëmijët janë të përfshirë, por ata nuk kanë ndikim mbi vendimet e bëra. Për shembull, kur një grup i udhëhequr nga të rriturit i detyron fëmijët të marrin pjesë në aktivitete pa pasur mundësi të shprehin mendimet e tyre.
- II. Dekorimi: Aktivitetet ku fëmijët janë të ftuar të kontribuojnë, por pa pasur ndonjë mundësi të rëndësishme për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes.
- III. Simulimi: Aktivitetet që paraqesin mundësi për fëmijët të kenë një rol të caktuar, por përsëri nuk është fjalë për ndihmesë të vërtetë në krijimin e vendimeve.
- IV. Asistenca: Fëmijët janë të ftuar të ndihmojnë në aktivitete, por nuk kanë mundësi të shprehin idetë ose mendimet e tyre për çështjet që lidhen me ato aktivitete.
- V. Pjesëmarrje e kufizuar: Këtu fëmijët janë përfshirë dhe mund të japin mendime dhe ide, por ende nuk kanë mundësi të marrin vendime të plota.
- VI. Pjesëmarrje autentike: Fëmijët kanë mundësinë të jenë pjesë e procesit të vendimmarrjes dhe të ndihmojnë në përcaktimin e aktiviteteve që do të zhvillohen.
- VII. Pjesëmarrje e shkrirë: Fëmijët janë të përfshirë plotësisht në procesin e krijimit të vendimeve, duke kontribuar në mënyrë të barabartë me të rriturit dhe duke pasur mundësi të ndikojnë në çdo aspekt të aktivitetit.

VIII. Kontrolli total: Fëmijët janë të plotë dhe të pavarur në vendimmarrje, duke pasur kontroll të plotë mbi aktivitetet dhe proceset që zhvillohen.<sup>6</sup>

Këto shkallë ilustrojnë mënyrat e ndryshme në të cilat fëmijët dhe të rinjtë mund të jenë të përfshirë në aktivitete, duke u kalitur në nivele më të thella pjesëmarrjeje dhe përgjegjësie përmes kalimit në çdo shkallë të hierarkisë.

## Roger Hart's Ladder of Young People's Participation



**Rung 8:** Young people & adults share decision-making

**Rung 7:** Young people lead & initiate action

**Rung 6:** Adult-initiated, shared decisions with young people

**Rung 5:** Young people consulted and informed

**Rung 4:** Young people assigned and informed

**Rung 3:** Young people tokenized\*

**Rung 2:** Young people are decoration\*

**Rung 1:** Young people are manipulated\*

Një model i dytë është ai i **OECD**. Analiza të shumta tregojnë që përfshirja e gamës së plotë të palëve të interesit në kërkimin e zgjidhjeve është thelbësore. Përkushtimi është më i rëndësishëm kur

---

<sup>6</sup> Hart, R. (1992). *Children's Participation: From Tokenism to Citizenship*. UNICEF.

kërkohet pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunimi i qytetarëve si pjesë e zgjidhjes së problemeve të ndryshme. Për të qenë sa më efektivë në adresimin e çështjeve të qeverisë në nivel qendror dhe lokal, veçanërisht kur sfidat janë komplekse dhe afatgjata, kërkohet përfshirja thelbësore e individëve dhe kryesisht të të rinjve, të cilët sjellin një dimension të ri dhe një qasje novatore në komunitetet ku banojnë.

Duke qenë se problematikat shpesh nuk kuptohen plotësisht, është e rëndësishme që ato të trajtohen dhe diskutohen në mënyrë të gjerë nga të gjithë aktorët e përfshirë, për të siguruar një kuptim të plotë të kompleksitetit të tyre. Në rastet kur një zgjidhje e mundshme, kërkon ndryshime në sjelljen e njerëzve, këto ndryshime nuk mund të imponohen lehtësisht. Sjelljet kanë më shumë gjasa të ndryshojnë kur çështjet kuptohen thellësisht, diskutohen dhe pranohen nga vetë njerëzit, sjellja e të cilëve synohet të ndryshohet.

Për rrjedhojë arritja e një kuptimi të përbashkët të dimensioneve të problemit dhe perspektivave të ndryshme në mes të palëve të interesit të ndryshme dhe në rastin konkret të rinjtë, të cilët mund të kontribuojnë në një kuptim të plotë dhe përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj çështjes është thelbësore.

Bashkëpunimi efektiv mes palëve sjell edhe përkushtimin e përbashkët për zgjidhjet e mundshme, duke mundësuar që secili kupton mirë pozicionin e tij për të pasur një dialog konstruktiv për zgjidhjen e problemit. Për shkak të kompleksitetit shoqëror, zgjidhja e një problemi është në thelb një proces shoqëror dhe sfida është se si të arrihet ky mirëkuptim i përbashkët në nivel praktik. Një pikënisje është angazhimi i qytetarëve dhe konkretisht i moshave të reja. OECD identifikon tre nivele të marrëdhënieve qeveri-qytetar në këtë kontekst.

**Informimi.** Qeveria shpërndan informacion mbi hartimin e politikave ose hartimin e një programi, ose projekti me impakt për të rinjtë dhe komunitetin e tyre. Burimet e informimit janë të ndryshme si institucionale, media etj, por kryesisht duke patur një marrëdhënie njëdrejtimëshe nga qeveria drejt individëve.


**Konsultimi.** Qeveria kërkon dhe merr informacione nga qytetarët (përfshirë edhe grupmoshat e reja) për politikëbërjen dhe hartimin e programit. Konsultimi krijon kështu një marrëdhënie dydrejtimëshe në mes të qeverisë dhe qytetarëve. Shembuj janë komentet mbi projekt ligjet, parashtrirat në pyetjet e komisionit parlamentar dhe sondazhet e opinionit publik etj.

**Pjesëmarrja aktive ose angazhimi i qytetarëve.** Kjo ndodh ku qytetarët angazhohen në mënyrë aktive në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Qytetarët mund të propozojnë opsione politike dhe të përfshihen në debate të ndryshme, megjithëse përgjegjësia përfundimtare për formulimin dhe rregullimin e politikave i takon qeverisë. Angazhimi i qytetarëve në hartimin e politikave dhe hartimin e programeve është një marrëdhënie e përparuar dydrejtimëshe në mes të qeverisë dhe qytetarëve bazuar në parimin e partneritetit. Shembujt përfshijnë grupe të hapura pune, panele të profesionistëve të fushës, forume të komunitetit dhe procese dialogu.

Pjesa më e madhe e literaturës argumenton se është i nevojshëm krijimi i nivelit të fundit dhe më të lartë të marrëdhënieve qeveri-qytetar për zgjidhjen efektive të problemeve, ku arritja e ndryshimeve të qëndrueshme të sjelljes është pjesë e zgjidhjes. OECD pranon që në praktikë mund të jetë e vështirë të bëhet një dallim i qartë në mes të konsultimit dhe angazhimit të qytetarëve. Të dy kërkojnë qasje të plotë dhe në kohë ndaj informatave të duhura, miqësore për përdoruesit, mbi çështjet që diskutohen dhe proceset që do të

përdoren. Si rregull i përgjithshëm, megjithatë, shtrirja kohore, formati dhe çështjet për konsultim përcaktohen nga qeveria derisa në pjesëmarrjen aktive të njëjtët faktorë janë vetë temë diskutimi dhe vendimi i përbashkët.

OECD gjithashtu mbështet disa parime bazë mbi të cilat bazohet pjesëmarrja aktive (ose angazhimi i qytetarëve). Ato përfshijnë:



**Së treti, sipas Kartelës së Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e Të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale “Shpreh Mendimin Tënd”,** ekzistojnë disa mënyra dhe modele sesi mund të suportohet pjesëmarrja dhe përfshirja e të rinjve në procese vendimmarëse:

### **1. Pjesëmarrja e të rinjve dhe trajnimet**

Të rinjtë duhet të marrin këshilla, udhëzim dhe mbështetje në lidhje me mënyrën më të mirë për t'u përfshirë në vendimmarrjet dhe veprimet që i prekin ata në shkollë, grupet rinore dhe në komunitetin e tyre. Megjithatë, njerëzit më të moshuar gjithashtu mund të kenë nevojë për trajnim mbi mënyrën më të mirë për të mbështetur të rinjtë në shprehjen e mendimeve të tyre.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të sigurojnë që mësuesit, punonjësit rinorë dhe të gjithë ata që punojnë me ose për të rinjtë, të marrin trajnim dhe udhëzim për këtë temë. Ata gjithashtu duhet të

ofrojnë trajnim, këshilla dhe mbështetje për të rinjtë dhe të sigurojnë që ato të ofrohen dhe organizohen në përputhje me nevojat e të rinjve.

## **2. Pjesëmarrja e të rinjve dhe informimi**

Një nga problemet më të mëdha është mungesa e informacionit të përshtatshëm dhe të disponueshëm në lidhje me aktivitetet, mundësitë dhe ngjarjet. Kjo mund të përfshijë gjithashtu mungesën e informacionit mbi shumë çështje të rëndësishme në jetën e të rinjve. Këto mund të përfshijnë: strehimin, punësimin, seksualitetin, ligjin, të drejtat, etj.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të mbështesin qendrat e informacionit për të rinjtë, ku ndodhet gjithë ky informacion dhe ku të rinjtë mund të kenë qasje dhe të ndihen komod në marrjen e tij. Këto qendra mund të jenë në shkolla, biblioteka, klube rinore, etj. Për më tepër, Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të përdorin mjetet moderne të komunikimit, p.sh. faqet e internetit për të ofruar këtë informacion. Faqet e internetit nuk duhet të jenë mjeti i vetëm, pasi jo çdo të ri ka qasje në internet.

## **3. Pjesëmarrja e të rinjve dhe media**

Revistat dhe gazetat, programet e radios dhe televizionit, si dhe interneti, luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e të rinjve. Ato mund të ofrojnë argëtim, informacion dhe mund të ndihmojnë konsumatorët të zhvillojnë opinione dhe të marrin vendime.

Megjithatë, të rinjtë rrallë kanë mundësinë të përfshihen dhe të kontribuojnë në produktet mediatike. Është më e vështirë për ta të kontribuojnë ose të zhvillojnë produktet e tyre mediatike, siç janë gazetat, programet lokale të radios dhe televizionit.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të ofrojnë trajnim për t'u mundësuar të rinjve një qasje më të lehtë në media dhe për të prodhuar produktet e tyre mediatike. Në të njëjtën kohë, ato duhet të ofrojnë mbështetje për krijimin e mediave të rinjve.

#### **4. Pjesëmarrja e të rinjve dhe aktivitetet e vullnetarizmit**

Revistat dhe gazetat, programet e radios dhe televizionit, si dhe interneti, luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e të rinjve. Ato mund të ofrojnë argëtim, informacion dhe mund të ndihmojnë konsumatorët të zhvillojnë opinione dhe të marrin vendime.

Megjithatë, të rinjtë rrallë kanë mundësinë të përfshihen dhe të kontribuojnë në produktet mediatike. Është më e vështirë për ta të kontribuojnë ose të zhvillojnë produktet e tyre mediatike, siç janë gazetat, programet lokale të radios dhe televizionit.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të ofrojnë trajnim për t'u mundësuar të rinjve një qasje më të lehtë në media dhe për të prodhuar produktet e tyre mediatike. Në të njëjtën kohë, ato duhet të ofrojnë mbështetje për krijimin e mediave të rinjve.

#### **5. Pjesëmarrja e të rinjve dhe projektet rinore**

Të rinjtë shpesh kanë ide për mënyra se si të përmirësojnë jetën ose të zgjidhin probleme në komunitetin e tyre, por u mungon inkurajimi dhe mbështetja e nevojshme nga autoritetet për t'i bërë ato realitet.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë idetë dhe projektet e tyre duke ofruar këshilla, fonde, hapësira etj. Nëse propozimi është i suksesshëm, ai ka potencialin të përmirësojë jetën e të gjithëve në komunitet. Edhe kur idetë ose

propozimet nuk mund të realizohen ose nuk janë të suksesshme, të rinjtë dhe autoritetet mund të mësojnë shumë nga kjo përvojë.

## **6. Pjesëmarrja e të rinjve dhe grupet rinore**

Grupet rinore që krijohen dhe drejtohen nga vetë të rinjtë janë një mënyrë ideale për të mësuar rreth pjesëmarrjes. Në këto grupe, të rinjtë mund të kenë një ndikim të vërtetë në vendimmarrje për atë që duan të bëjnë, duke i lejuar ata të marrin përgjegjësi të plotë për çështjet e tyre. Të gjithë të rinjtë duhet të kenë mundësinë të bashkohen ose të krijojnë një grup rinor nëse dëshirojnë.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të kenë një fond të veçantë për të mbështetur klube dhe grupe rinore, me theks të veçantë në ndihmën për ato grupe që krijohen dhe drejtohen nga vetë të rinjtë.

## **7. Pjesëmarrja e të rinjve dhe bashkë drejtimi**

Në nivelin evropian dhe në disa nivele lokale dhe kombëtare në disa shtete, ekziston një sistem i quajtur "Ko-menaxhim". Kjo do të thotë se ka një strukturë ku autoritetet dhe të rinjtë që përfaqësojnë organizatat rinore mblidhen shpesh. Të dy palët duhet të kenë të njëjtin numër përfaqësuesish dhe të kenë të njëjtat të drejta. Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të krijojnë këto struktura të "ko-menaxhimit" për t'u ofruar të rinjve mundësinë dhe aftësinë për të pasur një ndikim të vërtetë në vendimmarrjet dhe veprimet që i prekin ata.


## **8. Pjesëmarrja e të rinjve në grupimet politike**

Të rinjtë duhet të inkurajohen të përfshihen në të gjitha llojet e organizatave dhe kauzave. Prandaj, është e rëndësishme që ata të

kenë mundësinë, mundësitë dhe mbështetje për t'u angazhuar në të gjitha llojet e organizatave dhe grupeve, siç janë partitë politike, organizatat që merren me çështje të caktuara, etj.

Autoritetet Lokale dhe Rajonale duhet të ofrojnë financim për grupe dhe organizata që mirëpresin dhe mbështesin aktivisht të rinjtë për t'u përfshirë në aktivitetet dhe strukturat e tyre në të gjitha nivelet. Ata duhet të mbështesin të gjitha partitë politike për të inkurajuar angazhimin e të rinjve.

Në realitetin shqiptar, kur të rinjtë u pyetën “***Sa të gatshëm jeni të përfshiheni vullnetarisht në një projekt që ndihmon të rinjtë e tjerë?***”, u vu re gatimshmëria e menjëhershme për tu përfshirë në projekte me impakt në komunitet.



Rezultati që tregon se **59% e të anketuarve janë të gatshëm të përfshihen vullnetarisht në një projekt që ndihmon të rinjtë e tjerë** pasqyron një nivel të lartë të gatimshërisë për angazhim social dhe qytetar mes të rinjve. Ky përqindje tregon disa elementë pozitivë dhe potenciale:

***Ndërgjegjësimi për rëndësinë e ndihmës:*** Kjo përqindje sugjeron që shumica e të rinjve kanë një sens përgjegjësie sociale dhe janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e përfshirjes në projekte që kontribuojnë për të mirë të përbashkët.

***Potencial për fuqizim komunitar:*** Vullnetarizmi mund të ndihmojë në fuqizimin e të rinjve dhe komuniteteve lokale. Kjo shifër tregon një bazë solide për ngritjen e projekteve të suksesshme që synojnë zhvillimin social dhe edukativ të të rinjve.

***Nevoja për mbështetje dhe struktura të përshtatshme:*** Përqindja e lartë e gatishmërisë përfshin një potencial të shfrytëzueshëm, por gjithashtu nënkupton nevojën për institucione dhe organizata që të ofrojnë mundësi konkrete për vullnetarizëm, trajnim dhe mbështetje dhe se me planifikim dhe mbështetje të duhur, potenciali i këtij grupi mund të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë dhe komunitetit.

**Ndër modelet e suksesshme të propozuara nga vetë të rinjtë, për të rritur pjesëmarrjen e tyre, janë:**

- Organizimi i forumeve, aktiviteteve, klubeve, hackathoneve
- Përdorimi i rrjeteve sociale për informacion
- Informimi nepermjet shkollave, universiteteve
- Fuqizim i kapaciteteve të KVR-ve
- Krijimi i hapësirave rinore që qendrojnë aktive dhe krijimi i strukturave rinore të buxhetuara por edhe programeve apo thirrjeve për mbështetjen e ideve të rinjve.

## **VI. PËRFSHIRJA E TË RINJVE NË PROCESË VOTUESE**

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme duhet të vlerësohen si thelbi dhe baza e demokracisë, ndërkohë që zgjedhjet e pandershme përbëjnë një kërcënim serioz për demokracinë, lirinë e shprehjes dhe të ardhmen e një vendi.

Pjesëmarrja politike dhe angazhimi qytetar janë shtyllat kryesore të një kulture demokratike të qëndrueshme. Është thelbësore që të rinjtë të motivohen dhe të marrin rol aktiv në proceset e vendimmarrjes, duke qenë se ata përfaqësojnë një grup me nevoja dhe interesa specifike që duhet të përfshihen në politikëbërje. Demokracia përfiton nga qytetarë aktivë dhe pjesëmarrja e të rinjve, si në jetën sociale ashtu edhe në proceset politike.

Në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, në Qëllimin1, Masa 1.1.6, specifikohet: Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuere. Gjithashtu KQZ ka hartuar disa Strategji te edukimit zgjedhur për të mundësuar edukimin sa më të mirë të të gjithë brezave për procese sa më të sakta votimi. Në këtë kuadër, KQZ ka ndërmarrë një sërë iniciativash në zbatim të programeve specifike për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e target grupeve të veçanta dhe me fokus të vecantë gratë e vajzat.

Edukimi zgjedhor u jep të rinjve njohuritë e nevojshme për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në zgjedhje. Kjo përfshin njohjen me procedurat e votimit, procesin e identifikimit elektronik dhe numërimin elektronik, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë si votues.

Pjesëmarrja e të rinjve përfshin angazhimin në aktivitete në nivel lokal, si në organizatat rinore, grupet ombrellë, forumet politike, shoqatat studentore dhe organizata të tjera rinore të parashikuara nga legjislacioni. Kjo gjithashtu përfshin përfshirjen në debate publike, këshilla rinorë lokalë dhe procese vendimmarrjeje që ndihmojnë në përmirësimin e pozitës së tyre. Përmes këtij angazhimi, të rinjtë zhvillojnë aftësi të reja, marrin përgjegjësi për vendimet e tyre dhe kontribuojnë në komunitetet e tyre. Kjo do të thotë se të rinjtë duhet të shprehin dhe të krijojnë mendime, të marrin pjesë dhe të kenë fuqinë për të marrë vendime për çështje dhe aspekte që janë në interes të tyre.

## **6.1 Format e pjesëmarrjes së të rinjve në politikë.**

Organizatat ndërkombëtare dhe institucionet vendore kanë theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes rinore në ndërtimin e një shoqërie demokratike. Të rinjtë janë aktorë kyç në zhvillimin e komunitetit dhe duhet të kenë mundësinë të shprehin ide dhe të ndikojnë në vendime që ndikojnë drejtpërdrejt në të ardhmen e tyre. Angazhimi i tyre, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, jo vetëm që forcon demokracinë, por gjithashtu ndihmon në ndërtimin e shoqërisë gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Pjesëmarrja politike e të rinjve mund të shfaqet në forma të ndryshme dhe nuk kufizohet vetëm në anëtarësimin në parti politike. Ajo përfshin përfshirjen aktive në proceset e vendimmarrjes, ku të rinjtë kanë fuqinë dhe mundësinë të ndikojnë në këto procese dhe të veprojnë si aktorë politikë në nivele të ndryshme lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare.

Partitë politike nuk përfaqësojnë të vetmen mënyrë për angazhim politik. Të rinjtë kanë të drejtën të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre mbi politikat që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Pjesëmarrja politike mund të përfshijë forma të ndryshme si aktivizmin rinor në sektorin civil, ushtrimin e qytetarisë aktive, ose dhënien e kontributit në politikat dhe praktikat e ndryshme. Kjo mund të nënkuptojë angazhimin në këshillin rinor lokal, pjesëmarrjen në votime, apo kontributin në hartimin e strategjive për përfshirjen e grupeve të cenueshme dhe aktivitete të ngjashme.

Përfshirja dhe rritja e pjesëmarrjes së votuesve të rinj në zgjedhje, pavarësisht nga lloji i tyre, përbën një sfidë të madhe, por njëkohësisht është një mundësi për të rinjtë që të angazhohen në mënyrë aktive në jetën politike. Zgjedhjet qendrore dhe lokale ofrojnë hapësira ku të rinjtë jo vetëm që mund të ushtrojnë të drejtën e votës, por gjithashtu të kandidojnë si deputetë apo kryetarë bashkie në zonat ku jetojnë.

Përfaqësimi i të rinjve si deputetë, kryetarë bashkie, apo anëtarë të këshillave bashkiakë është një shembull konkret dhe frymëzues i pjesëmarrjes së tyre në proceset politike. Ky angazhim jo vetëm që rrit ndërgjegjësimin e brezit të ri për rëndësinë e demokracisë, por gjithashtu siguron që zëri i tyre të dëgjohet në vendimmarrje dhe politikat që ndikojnë në të ardhmen e komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

## **6.2 Mënyrat e ndryshme të vendimmarrjes në një Demokraci**

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të përcaktuar shumicën dhe vullnetin e qytetarëve. Shumica e thjeshtë (fiton ai që ka marrë numrin më të madh të votive), shumica e cilësuar (gjysma e votive plus një), kuorum (një përqindje e caktuar e votive, për shembull, një minimum prej 50% në mënyrë që vendimet e marra të quhen të vlefshme), ose përfaqësimi proporcional. Në rastin tonë ne përdorim sistemin e shumicës së thjeshtë.

Përparësia e sistemit zgjedhor maxhoritar (ose sistemi i votimit me një fitues të vetëm): është shumë i përhapur në vendet anglisht folëse si SHBA, Britania e Madhe ose India. Kuptohet lehtësisht dhe, në të shumtën e rasteve, garanton shprehjen e vullnetit të qytetarëve. Të çon në rezultate të qarta e të prera dhe ndihmon në fitimin e shumicës në parlament.

Pika të dobëta të sistemit zgjedhor maxhoritar: Dëshirat dhe vullneti i pakicave nuk merren parasysh. Për këtë arsye duhet të zbatohen masa për mbrojtjen e pakicave.

### **Në vijim paraqiten disa të dhëna bazë mbi proceset votuese.**

Demokracia është një formë e vendimmarrjes dhe e qeverisjes që ka si qëllim realizimin e barazisë së të gjithëve në fushën e pasurisë, të statusit social etj.

Qytetarët (të cilët përmbushin disa kritere) kanë të drejtë të zgjedhin pushtetet e tyre politike, të përcaktojnë politikën, ligjet dhe veprimet e shtetit.

Çdo qytetar (që përmbush disa kritere) ka të drejtë të zgjidhet në çdo funksion politik.

Zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe të ndershme. Zgjedhjet janë shprehje e vullnetit të lirë të qytetarit. Presionet e çdo lloji nga pushtetet ose kushdo tjetër që kanë qëllim të ndikojnë zgjedhjet e qytetarit nuk lejohen. Fshtësia e zgjedhjeve duhet të garantohet. Që zgjedhjet të vlerësohen të lira dhe të ndershme duhet të plotësojnë disa standarde ndërkombëtare.

Liritë civile, si për shembull, habeas corpus act (ndalimi i torturës), të drejtat e barabarta, liria e fjalës dhe liria e shoqërimit, si dhe procesi i duhur gjyqësor duhet të vendosen dhe të garantohen për të gjithë qytetarët.

Ndarja e pushteteve duhet të garantohet. Asnjë pushtet nuk duhet të ushtrojë të gjitha pushtetet. Pushteti ndahet ndërmjet parlamentit

(pushteti ligjvënës), qeverisë (pushteti ekzekutiv) dhe gjyqësorit (interpretimi dhe zbatimi i ligjit).

Media vlerësohet si pushteti i katërt dhe duhet të jetë e lirë dhe e pavarur nga çdo pushtet ose individ. Mediat duhet të kenë mundësinë të informojnë pa kufizime dhe në mënyrë të paanshme. Demokracia bazohet në vendimin e shumicës së qytetarëve të saj.

*Cilat janë hapat e ndryshme të një procesi zgjedhor?*

- Caktimi i zgjedhjeve (zakonisht nga parlamenti, nga qeveria ose nga presidenti, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin).
- Caktimi dhe përzgjedhja e kandidatëve (zakonisht nga partitë politike).
- Caktimi i çështjeve të fushatës (zakonisht nga partitë) për zgjedhjet e ardhshme.
- Fushatat e kandidatëve/mbulimi mediatik.
- Regjistrimi i kandidatëve dhe vlefshmëria e tyre.
- Regjistrimi i votuesve dhe vlefshmëria e listës zgjedhore
- Dita e zgjedhjeve dhe hapja e qendrës së votimit, vëzhgimi nga media dhe vëzhguesit.
- Zgjedhësit hedhin votat.
- Numërimi dhe shpallja e rezultatit

### **6.3 Cfarë duhet të dimë para zgjedhjeve për Kuvendin?**

Informacioni që vijon jep disa të dhëna praktike se si duhet të jetë një proces normal votimi për zgjedhjet për anëtarët e Kuvendit dhe çfarë duhet të kemi në parasysh si votues. Informacioni është i bazuar në: Ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008, **Kodi Zgjedhor i Republikës Së Shqipërisë**, (*Ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012 , nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020*), Neni 105, **Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit**, (*Ndryshuar pika 1, shkronja “a”, dhe shtuar fjali*

*në shkronjën “d”, me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, shfuqizuar fjalia e dytë e shkronjës “d” me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020). Procedurat si vijojnë:*

- Ditën e zgjedhjeve paraqituni në qendrën tuaj të votimit nga ora 07:00 deri në ora 19:00. Ju mund të gjeni qendrën tuaj të votimit këtu.
- Siguroheni që të keni me vete një dokument identifikimi, (letërnjoftim, ose pasaportë biometrike), të cilin e paraqesni përpara Komisionit të Qendrës së Votimit.
- Komisioni i Qendrës së Votimit verifikon identitetin tuaj dhe më pas ju vendosni gishtin e madh të dorës së majtë në pajisjen elektronike të identifikimit.
- Një anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit timbron me një bojë të posaçme gishtin e madh të dorës tuaj të majtë.
- Komisioni i Qendrës së Votimit do t’ju pajisë me fletën e votimit.
- Hyni i vetëm në dhomën e fshehtësisë.
- Në fletën e votimit ju do të shënoni me shenjën “x” ose “+” në kuadratin bosh për bri partisë politike, koalicionit apo kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit, që ju dëshironi.
- Më pas palosni fletën e votimit, në mënyrë që shenja “x” ose “+” të mos jenë të dukshme dhe të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës së votimit të jetë e dukshme.
- Dilni nga dhoma e fshehtësisë dhe hidhni fletën e votimit në kutinë e votimit.
- Votimi juaj tashmë ka përfunduar dhe ju largoheni nga qendra e votimit.

## VII. RASTE STUDIMORE DHE USHTRIME

### **Rasti 1 studimor: Buxhetimi me pjesëmarrje**

**Buxhetimi me Pjesëmarrje** përfaqëson një proces demokratik ku qytetarët përfshihen në mënyrë aktive në vendimmarrjen për shpërndarjen e burimeve financiare publike. Ky proces shkon përtej konsultimit, duke u bazuar në një dialog të drejtpërdrejtë dhe një diskutim transparent midis pushtetit vendor dhe qytetarëve. Ai është konsideruar si një nga praktikatat më të mira për të promovuar përfshirjen qytetare në vendimmarrje.

Qëllimi kryesor i **Buxhetimit me Pjesëmarrje** është krijimi i një lidhjeje të ngushtë midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) dhe qytetarëve, duke siguruar mekanizmat e duhur për shpërndarjen efektive të politikave të zhvillimit dhe për ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Përfshirja e qytetarëve në këtë proces ndihmon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore. Qytetarët fitojnë akses në informacion të detajuar mbi shpenzimet dhe investimet e planifikuara për vitin pasardhës dhe mund të vlerësojnë nëse sugjerimet dhe prioritetet e tyre janë marrë në konsideratë gjatë planifikimit financiar. Kjo rrit besimin e qytetarëve ndaj institucioneve vendore dhe fuqizon marrëdhëniet midis komunitetit dhe autoriteteve lokale.

Një aspekt thelbësor i programit buxhetor afatmesëm (PBA) dhe planifikimit financiar të bashkive është buxhetimi gjinor. Ky komponent, i përcaktuar si detyrim ligjor, synon të integrojë perspektivën gjinore në dokumentet financiare, duke promovuar barazinë gjinore në menaxhimin dhe shpërndarjen e burimeve

financiare. Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” e thekson këtë në nenin 2, pika 8, duke garantuar që barazia gjinore të jetë një prioritet në politikat e financimit në nivel vendor.

**Mekanizmi:** Sipas kuadrit ligjor aktual, organet e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të organizojnë konsultime publike me qytetarët në shumicën e proceseve të tyre vendimmarrëse. Ky detyrim rrjedh nga disa ligje kyçe, siç janë: Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

Këto dispozita ligjore kërkojnë nga bashkitë që të përfshijnë qytetarët në procesin e vendimmarrjes përmes mekanizmave si buxheti me pjesëmarrje dhe integrimi i perspektivës gjinore në buxhetim dhe në Programet Buxhetore Afatmesme (PBA). Këto janë komponentë të detyrueshëm që synojnë orientimin e shpenzimeve dhe investimeve drejt nevojave reale të komunitetit dhe garantimin e përfshirjes së gjerë të qytetarëve.

Në këtë kontekst, takimet për konsultime publike mbi buxhetin organizohen në çdo bashki dhe në secilën njësi administrative të saj. Për të lehtësuar këtë proces, në çdo bashki është caktuar një koordinator për konsultimin publik, i cili mbikëqyr dhe koordinon veprimtarinë për përfshirjen qytetare në vendimmarrje.

Një aspekt shumë i rëndësishëm për të zhvilluar konsultime publike efektive dhe që sigurojnë pjesëmarrje të qytetarëve është edhe sigurimi i njoftimit të qytetarëve në një periudhë të mëparshme, duke i përcaktuar qartë të dhënat bazë, si vendin e mbajtjes së konsultimit publik, orën, temën e diskutimit, vënia në dispozicion e materialeve

që do diskutohen, mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre etj.

Qëllimi i këtij ushtrimi është të angazhohjmë të rinjtë në krijimin e një buxheti pjesëmarrës për komunitetin e tyre, duke përfshirë edhe bashkëpunimin dhe njoftimin nga bashkia për të nxitur transparencën dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve të rinj dhe autoriteteve vendore.

### ***Hapat:***

1. **Prezantimi i Konceptit:**

Shpjegohen konceptete e te ardhurave dhe spenzimeve. Shpjegohet ideja e buxhetimit pjesëmarrës dhe rëndësia e përfshirjes së të rinjve.

2. **Formimi i Grupeve:** Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla, ku secili grup do të përfaqësojë një zonë apo lagje të komunitetit. Grupi do të bashkëpunojë për të paraqitur projektet e tyre

3. **Caktimi i Buxhetit dhe Kategorive:**

Jepni një buxhet hipotetik (p.sh., 100,000 €) të ndarë në kategori kryesore si:

- Infrastrukturë (rrugë, ndriçim)
- Mjedisi (pastrim, parqe)
- Edukimi (qendra rinore, aktivitete)

4. **Identifikimi i Nevojave të Komunitetit:**

Çdo grup harton prioritetet e zonës së tyre bazuar në nevojat e komunitetit dhe të dhënat që ofron bashkia.

5. **Krijimi i Propozimeve:**

Grupet përgatisin propozime për projekte që përfshijnë:

- Përshkrim të projektit
- Koston e pritshme

- Përfitimet për komunitetin
  - Kerkese Mbështetje nga bashkia
6. **Prezantimi i Porpozimeve dhe argumentimi i kerkesave duke simuluar shtiaten reale në Takim me Bashkinë:**  
Grupet prezantojnë idetë e tyre duke stimuluar Takim me Bashkinë.

Ky ushtrim nxit bashkëpunimin ndërmjet bashkisë dhe të rinjve, duke krijuar një model të integruar të pjesëmarrjes qytetare. Për referencë links: <https://financa.gov.al/viti-2024-2/>  
<http://financatvendore.al/buxhetet> dhe

**\*\*\*Shtojca 1 në fund, formatet e PBA.**

## **Rasti 2 studimor: Vullnetarizmi rinor**

**Qëllimi:** Të informohen të rinjtë për rëndësinë e vullnetarizmit dhe të inkurajohen të angazhohen në aktivitete komunitare.

## **Hyrja dhe diskutimi i hapur**

Prezanto konceptin e vullnetarizmit dhe përfitimet që sjell për individët dhe komunitetin.

Pyesni të rinjtë: "*Çfarë mendoni se do të fitoni nga përfshirja në aktivitete vullnetare?*" ose "*Cila është eksperiencia juaj më e mirë si vullnetar?*"

## **Aktiviteti praktik: Loja “Harta e mundësive”:**

Jepuni grupeve një fletë të madhe letre dhe markera.

Çdo grup duhet të vizatojë një hartë simbolike të komunitetit të tyre dhe të shënojë vende ku mund të kontribuojnë si vullnetarë (shkolla, qendra komunitare, institucione sociale).

Grupi diskuton dhe shkruan idetë për aktivitetet që mund të zhvillojnë si vullnetarë në këto vende.

### **Plani i veprimit:**

Secili grup përzgjedh një ide dhe krijon një plan të shkurtër veprimi për ta realizuar (p.sh., pastrimi i një hapësire publike, organizimi i një dite loje për fëmijët, mbledhje fondesh për një kauzë).

Prezantoni planet dhe diskutoni se si do të ndihmojë aktiviteti komunitetin.

### **Mbyllja dhe reflektimi:**

Diskutoni: *"Si mund të filloni të angazhoheni që tani?"*

Jepuni kontaktet e organizatave lokale që pranojnë vullnetarë dhe ftoni pjesëmarrësit të regjistruar për projekte të ardhshme.

**Rezultatet e pritshme:** Të rinjtë do të kenë një kuptim më të mirë të rëndësisë së vullnetarizmit, frymëzim për të filluar aktivitete konkrete në komunitetin e tyre, Rrjetëzimi me njëri tjetrin dhe zgjerimi i përfshirjes së tyre.

### **Rasti 3 studimor: Dialogu i strukturuar, një qasje për Përfshirjen Rinore në Vendimmarrje**

Dialogu i strukturuar është një proces komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve të ndryshme, i cili synon ndërtimin e mirëkuptimit dhe arritjen e konsensusit mbi çështje kyçe. Përdoret shpesh në kontekste politike, sociale dhe ekonomike për të krijuar ura dialogu dhe për të forcuar marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Në fokusin e të rinjve, dialogu i strukturuar shërben si një mekanizëm për të përfshirë zërin e tyre në politikëbërje, duke siguruar që shqetësimet dhe aspiratat e tyre të pasqyrohen në vendimmarrje.

Si funksionon Dialogu i Strukturuar?

Dialogu i Strukturuar ndjek një cikël me faza të qarta: konsultim, dialog dhe formulim rekomandimesh. Fillimisht, të rinjtë japin mendimet e tyre përmes pyetësorëve dhe aktiviteteve të tjera. Më pas, ata takohen me përfaqësues politikë në konferenca rinore kombëtare dhe evropiane për të diskutuar dhe propozuar zgjidhje për tema të caktuara, si përfshirja sociale apo punësimi rinor. Në fund, hartohen rekomandime konkrete që i dorëzohen institucioneve për përfshirje në politikëbërje.

### **Konsultimi dhe Avancimi i Politikave Rinore**

Dialogu i strukturuar siguron një platformë ku të rinjtë mund të adresojnë sfidat që i shqetësojnë, si:

Punësimi dhe zhvillimi i aftësive.

Barazia gjinore dhe të drejtat sociale.

Edukimi dhe qasja në mundësi të barabarta.

Kjo nxit hartimin e politikave që reflektojnë realitetet e përditshme dhe nevojat e brezit të ri.

## **Ngritja e Kapaciteteve për Angazhim Qytetar**

Të rinjtë zhvillojnë aftësi për: Komunikim dhe negociata, advokim për të drejtat e tyre, përfshirje në procese demokratike lokale dhe qendrore.

## **Ndërtimi i Platformave për Diskutim**

**Fizike:** Organizimi i tryezave të rrumbullakëta dhe forumeve ku të rinjtë dhe përfaqësuesit institucionalë mund të shkëmbejnë ide.

**Online:** Zhvillimi i hapësirave digjitale për diskutime dhe sondazhe që sigurojnë pjesëmarrje të gjerë dhe transparente.

Model Loje për Zbatimin e Dialogut të Strukturuar midis të Rinjve dhe Vendimmarrësve Politike me qëllim krijimin e një hapësire ndërveprimi ku të rinjtë dhe vendimmarrësit politikë (lokalë dhe qendrorë) të diskutojnë çështje të rëndësishme për komunitetin, duke përdorur metoda krijuese dhe dialog të strukturuar për të nxitur bashkëpunimin dhe kuptimin e ndërsjellë.

## **Struktura e Lojës:**

### **1. Përgatitja**

- **Numri i Pjesëmarrësve:** 20–40 persona (të rinj, përfaqësues të organizatave rinore, dhe vendimmarrës).
- **Hapësira:** Një sallë e madhe me tryeza pune, flipchart-e, materiale për shkrim dhe teknologji për prezantime vizuale.

## 2. Hapat e Lojës

### Faza 1: Prezantimi

- Facilitatori shpjegon qëllimin e lojës dhe vendos rregullat bazë për dialog të respektueshëm.
- Pjesëmarrësit ndahen në grupe të balancuara:
  - Grupet përfshijnë si të rinjtë ashtu edhe vendimmarrësit.
- Tema kryesore: "Zgjidhja e sfidave rinore në komunitet."

### Faza 2: Identifikimi i Problemeve

- Çdo grup diskuton dhe identifikon 2–3 probleme kryesore që prekin të rinjtë në komunitetin e tyre.
- Rezultatet regjistrohen në flipchart dhe prezantohen shkurtimisht.

### Faza 3: Krijimi i Zgjidhjeve

- Çdo grup krijon një plan konkret për zgjidhjen e një problemi të përzgjedhur, duke përfshirë:
  - **Përshkrimi i idesë**
  - **Hapat praktikë për zbatimin**
  - **Burimet e nevojshme (financiare, njerëzore, etj.)**
  - **Përfshirja e të rinjve dhe vendimmarrësve në proces**
- Grupet e tjera dhe vendimmarrësit japin feedback për idetë e paraqitura.

## Faza 4: Negocimi dhe Votimi

- Grupet negociojnë prioritetet bazuar në burimet dhe ndikimin e secilit propozim.
- Pas diskutimit, të gjithë pjesëmarrësit votojnë për idetë që do të përfshihen në një plan konkret veprimi.

## Faza 5: Zhvillimi i Deklaratës së Përbashkët

- Facilitatori mbledh përfundimet dhe ndihmon grupin të hartojë një deklaratë të përbashkët që përfshin:
  - Idetë kryesore të dakorduara.
  - Hapat e ardhshëm për zbatimin e planeve.
  - Angazhimet nga vendimmarrësit dhe të rinjtë.

## Rezultatet e pritshme

- **Dialog i Hapur dhe i Strukturuar:** Të rinjtë dhe vendimmarrësit ndajnë pikëpamje dhe krijojnë mirëkuptim.
- **Fuqizimi Rinor:** Të rinjtë ndihen të dëgjuar dhe të fuqizuar për të kontribuar në proceset vendimmarrëse.
- **Krijimi i Planit të Veprimit:** Përpilimi i një plani që përfshin zgjidhjet e përzgjedhura.

Kjo lojë ndërton një platformë për dialog efektiv dhe përfshirje rinore në vendimmarrje, duke nxitur një qasje demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

## Rast Studimor 4, "Konkursi Rinor për Zgjedhjet 2025"<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup> <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2024/09/Kriteret-dhe-cmimet.pdf>

Një iniciativë konkrete e shpallur nga KQZ, e cila mund të përdoret si trajnim ushtrim për të rinjtë. "Konkursi Rinor për Zgjedhjet 2025" synon të fuqizojë rininë shqiptare për të kontribuar në procesin zgjedhor përmes punimeve krijuese. Duke nxitur krijimin e grafikave, videove dhe sloganeve, konkursi synon të amplifikojë zërat e rinisë, të promovojë vlerat demokratike dhe të rrisë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen në zgjedhjet e vitit 2025. Përmbledhje e Përgjithshme: Kjo nismë synon të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në procesin zgjedhor të vitit 2025, duke u dhënë mundësinë të krijojnë grafika, video dhe slogane për fushatën ndërgjegjësuere të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kriteret e mëposhtme do të përdoren për vlerësimin e materialeve të dorëzuara, me fokus te origjinaliteti, ndikimi i mesazhit, kreativiteti, dhe efektiviteti në përfshirjen e të rinjve

## Bibliografi

**Analizë e Politikave Rinore në nivel Qendror,**

[https://krk.nrini.al/wp-content/uploads/2023/08/Untitled-1\\_compressed.pdf](https://krk.nrini.al/wp-content/uploads/2023/08/Untitled-1_compressed.pdf)

**CULTURAL AND SOCIAL AFFAIRS SUB-COMMITTEE ON YOUTH,** 1986. *Towards a Participatory, Comprehensive, and Coherent Youth Policy.* Preliminary draft by Prof. Willy FACHE.

**Dialog Global No. 25.** Participatory Budgeting Worldwide – Updated Version Study,

<https://estudogeral.uc.pt/bitstream/10316/42267/1/Participatory%20Budgeting%20Worldwide.pdf>

**Dialogu i Strukturuar NJË MEKANIZËM PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVENË POLITIKËBËRJE,** <https://krk.al/wp-content/uploads/2024/09/liberth-2.pdf>

**Eurodesk Strategy 2022-2027,** [https://eurodesk.eu/wp-content/uploads/2021/12/ED\\_6-year\\_strategy\\_single.pdf](https://eurodesk.eu/wp-content/uploads/2021/12/ED_6-year_strategy_single.pdf)

Grace, J., & Grace, P. (2017). *Youth Participation Handbook.*

Hart, R. (1992). *Children's Participation: From Tokenism to Citizenship.* UNICEF.

Holtom D., Watkins J., & Siladi S. (2016). *Study on the Social Value of Youth Organisations.* European Youth Forum.

[https://www.youthforum.org/sites/default/files/publication-pdfs/YFJ\\_StudyOnTheSocialValueOfYouthOrganisations\\_1P1.pdf](https://www.youthforum.org/sites/default/files/publication-pdfs/YFJ_StudyOnTheSocialValueOfYouthOrganisations_1P1.pdf)

Homana, G.A. (2018). *Youth Political Engagement in Australia and the United States: Student Councils and Volunteer Organizations as Communities of Practice.* Journal of Social Science Education, 17(1), 41–54.

**Kilioki, T.** (2020). *Perspective on Youth Participation*. Analytical Paper, Youth Partnership.

**Meaningful Youth Political Participation In Europe: Concepts, Patterns And Policy Implications**, Research study. Youth Partnership, Council of Europe, and European Commission.

Muxel, A. (2015). *Youth and Politics: Towards a New Model of Citizenship in Advanced Democracies*, pp. 25–27.

**National Survey: Young People and Politics in Albania**, ËFD. [https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey\\_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf)

**Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim** (2020). *Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri*. Youth Bank Hubs – Ëestern Balkans and Turkey.

Perovic, B. (2016). *Defining Youth in Contemporary National Legal and Policy Frameworks across Europe*, Youth Partnership. <https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47261653/Analytical+paper+Youth+Age+Bojana+Pero%20vic+4.4.16.pdf>

**PERSPECTIVES ON YOUTH PARTICIPATION**, Tomi Kiilakoski PhD, Youth Partnership. [https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/59895423/Kiilakoski\\_Participation\\_Analytical\\_Paper\\_final%252005-05.pdf](https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/59895423/Kiilakoski_Participation_Analytical_Paper_final%252005-05.pdf)

**Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life**. “Have Your Say!” <https://rm.coe.int/1680702379>

Stockemer, D. (2014). *What Drives Unconventional Political Participation? A Two-Level Study*. *The Social Science Journal*, 51, 201–211.

Studer, B. (2003). *Universal Suffrage and Direct Democracy: The Swiss Case, 1848–1990*. In Fauré C. (Ed.), *Political and Historical Encyclopedia of Women*, Routledge, New York.

Subirats, J. (2008). *If Participative Democracy is the Answer, What is the Question?* Eurotopia, 5.

Talpin, J. (2011). *Schools of Democracy: How Ordinary Citizens (Sometimes) Become Competent in Participatory Budgeting Institutions*. ECPR Press.

**T-KIT 15 Participatory Youth Policy.** <https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47261149/PREMS+026323+GBR+2600+TKIT+15+9346-9+Web.pdf>

**The Power of Youth: Instruments and Case Studies for Effective Youth Participation,** UNICEF.

<https://www.unicef.org/ukraine/en/reports/power-youth-instruments-and-case-studies-effective-youth-participation>

**Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë,** INSTAT.

[https://www.instat.gov.al/media/1731/t\\_rinjt\\_n\\_shqip\\_ri\\_sfidat\\_n\\_koh\\_t\\_q\\_ndryshojn\\_.pdf](https://www.instat.gov.al/media/1731/t_rinjt_n_shqip_ri_sfidat_n_koh_t_q_ndryshojn_.pdf)

**Youth Study Albania 2018-2019,** Friedrich Ebert Stiftung.

<https://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15261.pdf>

[https://www.instat.gov.al/media/1731/t\\_rinjt\\_n\\_shqip\\_ri\\_sfidat\\_n\\_koh\\_t\\_q\\_ndryshojn\\_.pdf](https://www.instat.gov.al/media/1731/t_rinjt_n_shqip_ri_sfidat_n_koh_t_q_ndryshojn_.pdf)

<https://www.osce.org/files/f/documents/b/6/482960.pdf><https://kqz.gov.al/si-duhet-te-votoj/>

<https://financa.gov.al/viti-2024-2/>

<http://financatvendore.al/buxhetet>

<https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/1770.pdf>

<https://riniafemijet.gov.al/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miratuar/>

# SHTOJCA 1

## Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve

| Nr. | Emri i Programit/Produktit   | Përshkrimi i Produktit  |
|-----|--|---|
| 1   | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)                      |   |
|     | Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim                          | Këtu përfshihen shërbimet e dhëna nga Kryetari, Nënkryetarët, kabineti, sekretari i përgjithshëm, drejtuesit dhe specialistët e lidhur me funksionet mbështetëse të NJVQV si Burimet Njerëzore, Financa, IT, Juridike, Prokurime, Auditi, etj. (përfshirë QKR, QKB, NJA, kryepleqtë). Pagesa e Pagave dhe sigurime apo honorare për stafin. |
|     | Akte te miratuara nga Këshilli Bashkiak                              | Shërbime të ofruara nga Këshilli Bashkiak dhe stafi i tij kundrej administratës dhe komunitetit. Pagesa e honorareve për anëtarët e KB dhe shpenzimeve të tjera për funksionimin e KB.  |
|     | Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë | Funksionimi dhe mirembajtja e Infrastruktures fizike te bashkise përmes sigurimit të shpenzimeve korente apo kapitale për ujë, energji elektrike, internet, telefon, mirëmbajtje, kancelari, karburant dhe mirëmbajtje për mjetet e transportit, pajisje apo furnitura të tjera IT, etj.  |

|  |   |  |
|--|---|--|
|  | <b>Përbushja e Detyrimeve Gjyqësore</b> | Ndjekja e çështjeve gjyqësore dhe shlyerja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.   |
|  | <b>Nëpunës të trajnuar</b>              | Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë NJVQV apo palë të treta (p.sh. ASPA, projekte të ndryshme, etj.) Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambjente trajnimi, pagesa për trajnesit, shpenzime transporti, akomodimi, dieta, etj.   |
|  | <b>Subjekte tregtare të Inspektuara</b> | Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me Drejtorinë e të Ardhurave (apo Taksave Vendore), duke filluar nga kostot e personelit; shpenzime korente apo kapitale për funksionimin (utilitare, karburant, kancelari, etj.) apo mirëmbajtje (automjetesh apo infrastrukture tjetër fizike); shpenzimet për dieta, transport, etj.; shpenzime për promovime apo fushata sensibilizuese; shpenzimet për barrën siguroese dhe hipotekore, urdhra bllokimi, pagesa per RBS nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, etj. |
|  | <b>Transparenca publike</b>             | Shërbime dhe kostot përkatëse të printimit (ftesa, broshura, m baner, city light, kartolina, albume), prodhim spoti promovues, mbështetje për hostimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ëbsite,  |

|          |  |   |
|----------|--|---|
|          |  | promovimi i aktiviteteve në rrjetet sociale, etj.   |
| <b>2</b> | <b>Shërbimet e Policisë Vendore (03140)</b>            |   |
|          | <b>Patrullim për sigurinë publike</b>                  | Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet e Policisë Bashkiake në lidhje me inspektimet për parandalimin e kundravajtjeve administrative (shpenzime karburant, automjete, uniforma); Kostot e personelit të policisë bashkiake (paga dhe sigurime), etj.  |
| <b>3</b> | <b>Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)</b> |   |
|          | <b>Shërbime të mbrojtjes civile</b>                    | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.   |
|          | <b>Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit</b>    | Ky produkt ka të bëjë me krijimin e gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj. Këtu do të përfshihen njëkohësisht edhe aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme sensibilizuese. |
|          | <b>Punonjës zjarrfikës të trajnuar</b>                 | Zhvillimi i stafit në lidhje me proceset e trajtimit të rasteve të zjarrit dhe shpëtimit përmes trajnimeve apo programeve   |

|          |  |  |
|----------|--|--|
|          |  | kualifikuese të zhvilluara nga vetë njësia apo palë të treta (p.sh. MB, projekte të ndryshme, etj.) Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambjente trajnimi, pagesa për trajnuesit, shpenzime transporti, akomodimi, dieta, etj. |
|          | <b>Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore</b> | Shpenzimet e parashikuara në buxhetin e njësisë të vetëqeverisjes vendore për dëmshpërblimin e familjeve të cilat preken nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore.  |
|          | <b>Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri</b>               | Shpenzimet nga buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore për shpërblimin e familjeve të dëmtuara nga zjarri sipas legjislacionit për mbrojtjen civile  |
|          | <b>Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente</b>                       | Aktivitetet dhe Shpenzimet e parashikuara në buxhetin e njësisë të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e punimeve të karakterit parandalues dhe emergjent të lidhura me emergjencat civile   |
| <b>4</b> | <b>Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik (04130)</b>                    |  |
|          | <b>Plani Strategjik i Zhvillimit</b>                               | Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me hartimin apo rishikimin e planit strategjik të zhvillimit të NJVQV.  |
|          | <b>Mbeshtetje me grante për biznesin e vogël</b>                   | Ky produkt paraqet buxhetin e caktuar nga NJVQV për skemën e granteve konkurruese që do të akordohen me qëllim   |

|  |   |  |
|--|---|--|
|  |   | zhvillimin e startup-eve, biznesit të vogël, etj.  |
|  | <b>Promovimi i Biznesit dhe zhvillimit Ekonomik</b>       | Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme me qëllim ndihmesën dhe promovimin e biznesit dhe zhvillimit ekonomik.  |
|  | <b>Subjekte të sistemuara në Tregun e Ushqimeve</b>       | Materiale konsumi, energjia elektrike, shërbimi dhe materiale të tjera mirëmbajtjeje, materiale hidraulike, shpenzime mirembajtjeje kaldaje, materiale ndricimi, pagesa e ujit, shpenzime pastrimi dhe disinfektimi, shpenzime sigurimi, etj. për tregun ushqimor.   |
|  | <b>Subjekte të sistemuara në Tregun e Gjësë së Gjallë</b> | Materiale konsumi, energjia elektrike, shërbimi dhe materiale të tjera mirëmbajtjeje, materiale hidraulike, shpenzime mirembajtjeje kaldaje, materiale ndricimi, pagesa e ujit, shpenzime pastrimi dhe disinfektimi, shpenzime sigurimi, etj. për tregun e gjësë së gjallë.                                      |
|  | <b>Tregje të inspektuara</b>                              | Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot që lidhen me inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm me çertifikim veterinar dhe agrokulturor në pikat e prodhimit dhe tregtimit të produkteve blektoriale dhe bujqësore. Këtu do të përfshihen si shpenzimet e personelit, ashtu edhe ato të operimit të shërbimit. |
|  | <b>Shërbimi i Stafit të zhvillimit të Turizmit</b>        | Ofrimi i shërbimit turistik dhe pagesa e pagave e sigurimeve për stafin e turizmit dhe mbështetjen operative.  |

|   |  |  |
|---|--|--|
|   | <b>Promovimi i Turizmit</b>  | Promovimi i turizmit realizohet, por nuk kufizohet në shërbimet e Zyrës së Info Point, promovimi i destinacioneve të ndryshme turistike; hartimi dhe shpërndarja e hartave turistike, udhërrëfyesve, etj.; realizimi i aktiviteteve të ndryshme promovuese si Dita Botërore e Edukimit; dita botërore e turizmit; etj. |
| 5 | <b>Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve (04220)</b> |  |
|   | <b>Trajtimi i kafshëve endacake</b>  | Shpenzime për trajtimin e kafshëve endacake (ushqime, disterilizime etj) në formë ambulante apo nëpërmjet qendrave të ngritura për këtë qëllim.  |
|   | <b>Grante për fermerët</b>   | Ky produkt përfshin shpenzimet për grantet e dhëna fermerëve për zhvillimin e kulturave apo projekteve të ndryshme.  |
|   | <b>Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor</b>                                 | Kë produkt përfshin aktivitetet dhe kostot përkatëse të lidhura shërbimit e këshillimit dhe ekstensionit bujqësor.   |
| 6 | <b>Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)</b>                             |  |
|   | <b>Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese</b>                               | Mirëmbajtja rutinë e XX Km lineare kanale ujitës dhe YY Km lineare kanale kulluese nëpërmjet pastrimit, sistemimeve, mirëmbajtjeve, meremetimeve apo zëvendësimit të torbinove, etj. Këtu përfshihen shpenzime e personelit për ofrimin rutinë të shërbimit të menaxhimit  |

|          |   |   |
|----------|---|---|
|          |   | të ujitjes dhe kullimit si energji elektrike, kancelari, mjete dhe pajisje, materiale ndërtimi, etj.  |
| <b>7</b> | <b>Administrimi i pyjeve dhe kullotave</b>                          |   |
|          | <b>Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor</b> | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e monitorimit dhe mbrojtjes së tokës dhe pyjeve.   |
|          | <b>Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore</b>         | Ky produkt përfshin aktivitetet e inspektimit të të gjitha hapësirave kullosore dhe pyjore për prerje të paligjshme të lëndës drusore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme, si edhe kostove të nevojshme të lidhura me funksionimin e këtij shërbimi. |
|          | <b>Sipërfaqe kullotë e pastruar në NJA</b>                          | Pastrimi dhe sistemimi i sipërfaqeve të kullotave për t'i bërë ato të gatshme për shfrytëzim.   |
|          | <b>Sipërfaqe kullotë e rehabilituar</b>                             | Investime dhe rehabilitime të sipërfaqeve të kullotave malore dhe fushore; pastrimi dhe sistemimi i baseneve të ujit; etj.  |
|          | <b>Sipërfaqe pyjore e rehabilituar</b>                              | Ripyllëzimi i sipërfaqeve të djegura dhe sipërfaqeve të përdorura duke investuar në pyje me standartin 1667 fidanë/ha sipas skemës 3m x 2m; sisteme malore me gabiona dhe mure guri; etj.   |
| <b>8</b> | <b>Rrjeti rrugor rural (04520)</b>                                  |   |

|          |   |   |
|----------|---|---|
|          | <b>Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural</b> | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale   |
|          | <b>Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur</b>                       | Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e XX Km infrastrukturës rrugore rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve dhe i procedurave të prokurimit për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve; sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj.  |
|          | <b>Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar</b>                      | Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe lidhja e rrugëve dytësore me ato kryesore dhe nacionale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve, procedurave të prokurimit dhe zbatimi i ndërhyrjeve në rehabilitimin e rrugëve përmes zëvendësimit të shtresave të asfaltit, shtrimi i shtresave shtesë, pajisja e infrastrukturës rrugore rurale me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, etj. |
| <b>9</b> | <b>Transporti Publik (04570)</b>                              |   |
|          | <b>Shërbimi i Transportit Publik</b>                          | Lëvrimi i Shërbimeve të transportit publik dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për punonjësit e mirëmbajtjes së transportit publik; investimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të transportit publik; etj.  |

|           |  |   |
|-----------|--|---|
|           | <b>Qytetarë të subvencionuar ne transportin publik</b>           | Pensionistë, studentë, apo grupe të tjera në nevojë të subvencionuar për shërbimin e transportit publik.  |
| <b>10</b> | <b>Menaxhimi i mbetjeve (05100)</b>                              |   |
|           | <b>Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit</b> | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Pastrimit të qytetit, NJA; mbledhjen, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve.  |
|           | <b>Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane</b>      | Mbetje të ngurta të mbledhura dhe të transportuara nga zonat urbane drejt vend-depozitimeve në një vit. Këtu përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e blerjes së karburantit për drejtimin e operacioneve të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave një herë në ditë për një distancë mesatare prej XX km në ditë; blerjen, mirëmbajtjen dhe dizifektimin e kontenierëve të mbetjeve; mirëmbajtjen apo ripërtëritjen e mjeteve dhe pajisjeve të transportit apo grumbullimit; etj. |
|           | <b>Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve</b>                        | Mbetje të ngurta nga zonat urbane dhe rurale të depozituara dhe trajtuara në landfill-e nga vetë bashkia apo nga një subjekt i kontraktuar (kundrejt tarifës së depozitimit). Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet përkatëse të trajtimit të mbetjeve në vend-depozitim.  |
|           | <b>Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale</b>      | Mbetje të ngurta të mbledhura dhe të transportuara nga zonat rurale drejt vend-depozitimeve në një vit. Këtu përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e blerjes së   |

|    |  |  |
|----|--|--|
|    |  | karburantit për drejtimin e operacioneve të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave dy herë në javë për një distancë mesatare prej YY km në ditë; blerjen, mirëmbajtjen dhe dizifektimin e kontenierëve të mbetjeve; mirëmbajtjen apo ripërtëritjen e mjeteve dhe pajisjeve të transportit apo grumbullimit; etj. |
|    | <b>Pastrimi i rrugëve dhe parqeve</b>                      | Kjo është sipërfaqja e rrugëve urbane që fshihet/lahet çdo ditë gjatë gjithë vitit. Këtu përfshihen edhe shpenzimet për kriposjen e rrugëve apo pastrimin e tyre nga dëbora gjatë muajve të dimrit.  |
|    | <b>Subjekte të inspektuara</b>                             | Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot që lidhen me inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të subjekteve apo aktiviteteve me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Këtu do të përfshihen si shpenzimet e personelit, ashtu edhe ato të operimit të shërbimit.   |
|    | <b>Promovimi i mbrojtjes së mjedisit</b>                   | Realizimi I aktiviteteve të ndryshme për sensibilizimin apo impakt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit.  |
|    | <b>Shërbimi i Stafit të Mbrojtjes së Mjedisit</b>          | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për stafin e mbrojtjes së mjedisit.  |
| 11 | <b>Planifikimi urban vendor (06140)</b>                    |  |
|    | <b>Inspektime të zhvilluara për mbrojtjen e territorit</b> | Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet inspektuese dhe shpenzimet përkatëse të kryera nga inspektoriatet e ndërtimit.   |

|    |  |  |
|----|--|--|
|    |  | Shpenzimet janë ato të paga dhe sigurime për stafin e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, si edhe shpenzime të tjera të operimit të shërbimit.  |
|    | <b>Projekte të zhvillimit urban të hartuara dhe monitoruara</b>            | Hartimi i projekteve të ndryshme nga drejtoria e urbanistikës dhe planifikimit urban; leje për zhvillimin e zonave/njësite të komunitetit (të reja ose rehabilituara); etj. Këtu do të paraqiten shpenzimet për paga dhe sigurime për stafin e drejtorisë së urbanistikës, si edhe cdo shpenzim tjetër të lidhur me aktivitetin e kësaj drejtorie. |
| 12 | <b>Sherbimet Publike Vendore (06260)</b>                                   |  |
|    | <b>Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelbërimit, varrezave</b> | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave, dekorit të qytetit.   |
|    | <b>Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave</b>                               | Sipërfaqe ekzistuese e varrezave të qytetit të mirëmbajtura. Mirëmbajtja dhe sistemimi i parcelave të varrezave, rrugëve dhe trotuarëve ndarës; prokurimi i fidanëve; sistemimi i zonave të gjelbërta; etj.  |
|    | <b>Rruge urbane e mirëmbajtur dhe rehabilituar</b>                         | Rruge urbane e mirëmbajtur në qytetet e NJVQV duke bërë kontrollë dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, rregullimin e sinjalistikës; etj.  |
|    | <b>Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur dhe rehabilituar</b>                  | Mbjellje, shërbim, dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm, shërbim bari i  |

|  |  |   |
|--|--|---|
|  |  | kultivuar, natyral, tapet bari, uje, punim rrënjësh, pleherim, spërkatje me pesticide. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirëmbajtjes për dy makineri (2 prerëse bari)  |
|  | <b>Trotuare të mirëmbajtur dhe rehabilituar</b>              | Sipërfaqe trotuaresh e mirëmbajtur në qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, zëvendësimi i pllakave dhe bordurave, rregullimin e sinjalistikës; rregullimin e stolave; etj.  |
|  | <b>Objekte publike të mirëmbajtura</b>                       | Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme administrative në pronësi të bashkisë, si psh. lapidare, shatërvane, etj.  |
|  | <b>Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes së Ndricimit Publik</b> | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për stafin që merret me Ndricimin Publik  |
|  | <b>Rrjeti i ndricimit rrugor publik urban i mirëmbajtur</b>  | Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat qytet të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi i 1000 llambave të ndriçimit LED për zëvendësimin e llambave me ndricim të ngrohtë, 55 shtyllave të ndriçimit, 10 km kablllo elektrik; etj. |
|  | <b>Rrjeti i ndricimit rrugor publik rural i mirëmbajtur</b>  | Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat rurale të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi i 100 llambave të ndriçimit, 5 shtyllave të ndriçimit, 1 km kablllo elektrik; etj.   |

|           |  |   |
|-----------|--|---|
|           | <b>Dekori i Qytetit</b>                                | Në këtë produkt përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet përkatëse të planifikuara për dekorimin e qytetit me rastin e festive apo aktiviteteve zyrtare.   |
| <b>13</b> | <b>Furnizimi me Uje dhe Kanalizime (06370)</b>         |   |
|           | <b>Kanalizime të Ujërave të Bardha të Mirëmbajtura</b> | Në këtë produkt do të përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e kryera nga NJVQV për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha.  |
| <b>14</b> | <b>Sherbimet e Kujdesit Paresor (07220)</b>            |   |
|           | <b>Qendra shëndetësore të mirëmbajtura</b>             | Mirëmbajtjet elektrike, hidrosanitare, dyer, dritare, lyerjet, etj. për qendrat e shërbimit shëndetësor primar.   |
|           | <b>Promovim dhe edukim për mbrojtjen e shëndetit</b>   | Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për promovimin e shëndetit.   |
|           | <b>Qendra shëndetësore të rikonstruara</b>             | Rikonstruksion i infrastrukturës fizike të qendrave shëndetësore të kujdesit parësor apo konsultoreve të nënës dhe fëmijëve me ndërhyrje të tilla të rëndësishme si zëvendësim çatie, instalime në sisteme të brendshme elektrike apo ngrohje, etj. |
| <b>15</b> | <b>Sport dhe argëtim (08130)</b>                       |   |
|           | <b>Shërbimi i stafit të Sportit dhe Argëtimit</b>      | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që merret me aktivitetet artistike dhe kulturore të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.                                    |

|           |   |   |
|-----------|---|---|
|           | <b>Disiplinat e ndryshme sportive të mbështetura</b>                      | Shpenzimet e planifikuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për të mbështetur sportisë, stafet mbështetëse të disiplinave sportive dhe trajtimin financiar të tyre. Sipas disiplinave do të kostohen shpenzimet referuar nevojave për paga, uniforma, dieta etj. Tregues i cili do të paraqitet në sipërfaqen e mjediseve sportive dhe argëtuese të shtuara në vit. Këtu do të përfshihen edhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e terreneve sportive në dispozicion të disiplinave të ndryshme sportive. |
|           | <b>Mbështetje për klubin e futbollit</b>                                  | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të mbështetur financiarisht aktivitetin e klubeve të futbollit që kanë në pronësi bashkitë. Përfshihen këtu shpenzimet për klubet e futbollit të femrave.   |
| <b>16</b> | <b>Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat (08220)</b>  |   |
|           | <b>Shërbimet e stafit të trashëgimisë Kulturore, muzeve, bibliotekave</b> | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që mbulon objektet e trashëgimisë kulturore, muzetë dhe bibliotekat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore.  |
|           | <b>Objekte të trashëgimisë kulturore të mirëmbajtura</b>                  | Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të përfshijnë në këtë produkt shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e objekteve të   |

|  |  |   |
|--|--|---|
|  |  | trashëgimisë kulturore brenda territorit të tyre.   |
|  | <b>Promovimi i trashëgimisë kulturore</b>  | Shpenzimet për broshura, për pika informimi, shfaqje kulturore dhe artistike për promovimin e trashëgimisë kulturore apo forma të tjera për promovimin e trashëgimisë kulturore brenda territorit të njësisë të vetëqeverisjes vendore.   |
|  | <b>Funksionimi i Bibliotekës</b>   | Shpenzimet për mirëmbajtjen, funksionimin dhe shtimin e fondit të librave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrojnë bibliotekat në territorin e njësisë të vetëqeverisjes vendore.  |
|  | <b>Shërbimet e stafit të Artit dhe Kulturës</b>  | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që merret me aktivitetet artistike dhe kulturore të njësisë të vetëqeverisjes vendore.  |
|  | <b>Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale</b> | Njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë shpenzime në këtë produkt për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të objekteve të veprimtarisë kulturore dhe artistike.  |
|  | <b>Shfaqje teatri</b>  | Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet për materialet e nevojshme të shfaqjeve të teatrit (kostume, skena, etj.), dieta, honorare apo transporti për realizimin e shfaqjeve jashtë territorit të NJVQV, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu shpenzimet e njësisë të vetëqeverisjes vendore për të mbuluar kostot e |

|           |   |  |
|-----------|---|--|
|           |   | mirëmbajtjes dhe funksionimit të teatrit publik në pronësi bashkë.   |
|           | <b>Shfaqje kinemaje</b>   | Shpenzimet e njërive të vetëqeverisjes vendore për të mbuluar kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit të kinemave publike në pronësi bashkë. Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet për materialet e nevojshme të funksionimit të kinemave të bashkisë, fondi për blerjen/marrjen me qera të filmave, etj.   |
| <b>17</b> | <b>Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë (09120)</b>                       |  |
|           | <b>Shërbime mbështetëse të stafit të Arsimit Bazë</b>                           | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet mbështetëse të arsimit bazë, përfshirë atë parashkollor.  |
|           | <b>Objekte të arsimit baze dhe parashkollor të mirëmbajtura dhe funksionale</b> | Shpenzimet në buxhetin e njërive të vetëqeverisjes vendore të planifikuara për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve të arsimit bazë. Mirëmbajtja ka të bëjë me atë elektrike, hidrosanitare, klasat, dyer, dritare, lysterjet, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet e funksionimit dhe ruajtjes (ujë, energji elektrike, ngrohje, dizifektim, sanitare, internet, kamerat e sigurisë, kancelari për sekretariatë, etj.) |
|           | <b>Fëmijë që ndjekin kopshtin</b>   | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për materiale të ndryshme didaktike që i shërbejnë   |

|    |   |  |
|----|---|--|
|    |   | fëmijëve të kopshteve. Këtu përfshihen shpenzimet për funksionimin e kopshteve (ujë, energji elektrike, ngrohje, shpenzimet e sigurisë), shpenzimet e mirëmbajtjes, kuzhinat e trajtimit ushqimor të fëmijëve, etj.  |
|    | <b>Eduktorë të kualifikuar/trajnuar</b>                                   | Shpenzimet e njësisë të vetëqeverisjes vendore për të mbuluar trajnimin apo kualifikimin e edukatorëve me qëllim rritjen e kapaciteteve. Në këtë produkt përfshihen të gjitha kostot për çdo edukator të trajnuar (shpenzime kursi trajnimi, dieta, transport, etj.)   |
|    | <b>Fëmijë që frekuentojnë qendrat kulturore të fëmijëve</b>               | Shpenzimet për funksionimin e qendrave kulturore të fëmijëve në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin (materiale për kurset, ujë, energji elektrike, ngrohje, etj.) e këtyre qendrave, pagesat për ekspertët e jashtëm, zhvillimin e kurseve të ndryshme të baletit, kitarës, pikturës, etj. |
|    | <b>Objekte të arsimit bazë dhe parashkollor të rikonstruara</b>           | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për rikonstruksionin e objekteve të arsimit parashkollor si pasojë e amortizimit.  |
| 18 | <b>Arsimi i mesëm i përgjithshëm(09230)</b>                               |  |
|    | <b>Sherbime Mbeshtesese të stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm</b> | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet   |

|  |  |  |
|--|--|--|
|  |  | mbështetëse të arsimit të mesëm të përgjithshëm.   |
|  | <b>Objekte te arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale</b> | Shpenzimet në buxhetin e njësisve të vetëqeverisjes vendore të planifikuara për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm. Mirëmbajtja ka të bëjë me atë elektrike, hidrosanitare, klasat, dyer, dritare, lyerjet, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet e funksionimit dhe ruajtjes (ujë, energji elektrike, ngrohje, dizifektim, sanitare, internet, kamerat e sigurisë, kancelari për sekretaritë, etj.) |
|  | <b>Nxënës të akomoduar në konvikt</b>                              | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e njevetëqeverisjes vendore për konviketet e arsimit të mesëm duke ju referuar numrit të nxënësve në këto objekte. Këto shpenzime përfshijn rinovimin e paisjeve, rregullimet e brendshme, shpenzimet utilitare, të sigurisë, mençat dhe ushqimin për fëmijët konviktorë, etj. Përfshirë këtu shpenzimet për nxënësit e komuniteti rom të akomoduar në konvikte.  |
|  | <b>Nxënës të trajtuar me bursë</b>                                 | Shpenzimet për trajtimin e nxënësve të arsimit të mesëm të përgjithshëm me bursë sipas kriterëve të përcaktuara. Shpenzimet do të lidhen më numrin e nxënësve që do të jenë përfitues  |
|  | <b>Konvikte të rikonstruata</b>                                    | Shpenzimet e planifikuara për rikonstrukcionin e konvikteve të arsimit të  |

|           |  |   |
|-----------|--|---|
|           |  | mesëm të përgjithshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.   |
| <b>19</b> | <b>Përkujdesja Sociale (10430)</b>                                 |   |
|           | <b>Shërbimi i stafit të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet</b>      | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në kujdesin social të familjeve dhe fëmijëve në nevojë.   |
|           | <b>Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social</b>                    | Shpenzimet buxhetore për mbulimin e fëmijëve që përfitojnë shërbimet të caktuara nga qendrat e shërbimit social apo shtëpitë e foshnjës në administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Referuar numrit të fëmijëve që përfitojnë shërbim pranë këtyre funksioneve do të përllogariten shpenzimet e planifikuara për realizimin e këtij produkti. |
|           | <b>Fëmijë që frekuentojnë cerdhet</b>                              | Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me fëmijët të cilët frekuentojnë çerdhet publike në admisnitrimin e tyre. Kosto e këtij produkti do të jetë sa vlera e parashikuar e mbështetjes buxhetore për veprimtarinë operacionale, furnizimin me ujë, energji elektrike, ngrohje, shërbimet e sigurisë, trajtimi ushqimor, etj.         |
|           | <b>Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE</b> | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në buxhetin e tyre për mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skemat e Ndhmës Ekonomike.  |

|    |   |  |
|----|---|--|
|    | <b>Objekte të shërbimit të kujdesit social për familje dhe fëmijë të mirëmbajtura</b> | Të gjitha shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e godinave të njësisve të vetëqeverisjes vendore të cilat janë në funksion të kujdesit social për familje dhe fëmijë.   |
|    | <b>Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social</b>   | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara nën administrimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore.   |
|    | <b>Persona që përfitojnë kujdesin social</b>  | Shpenzimet që lidhen me qendrat ditore të kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe kostot e tjera të funksionimit të këtyre qendrave përfshihen në këtë produkt. Përfshirë këtu treguesit e grave, të moshuarve dhe femijëve të asistuar me shërbim social. |
|    | <b>Individë AK që përfitojnë trajtim</b>  | Fondi e veta në dispozicion të njësisve të vetëqeverisjes vendore për të mbështetur shërbimet ndaj individëve me aftësi të kufizuara. Shpenzimet lidhen me numrin e individëve që përfitojnë trajtim me fondin mbi aftësitë e kufizuara.   |
|    | <b>Shërbime sociale për grupet në nevojë të financuara nga fondi social</b>           | Të gjitha shpenzimet që lidhen me financimin e shërbimeve ekzistuese, planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror, si dhe zhvillimin e politikave sociale.   |
| 20 | <b>Strehimi social (10661)</b>  |  |

|  |  |  |
|--|--|--|
|  | <b>Shërbimi i stafit të strehimit social</b>                     | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e strehimit social.  |
|  | <b>Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë</b>    | Shpenzimet që planifikon njësi e vetëqeverisjes vendore për të mbuluar detyrimin për subvencionim në kuadër të mbrojtjes sociale të familjeve përfituese të programit të subvencionimit të qerasë së shtëpisë. Niveli i shpenzimeve do të mbështetet mbi numrin e familjeve apo individëve të cilët janë përfitues në atë program. |
|  | <b>Familje/Individë të subvencionuar për interesin e Kredisë</b> | Shpenzimet që planifikon njësi e vetëqeverisjes vendore për të mbuluar detyrimin për subvencionim në kuadër të mbrojtjes sociale të familjeve përfituese të kredisë me norma interesi favorizuese. Niveli i shpenzimeve do të mbështetet mbi numrin e familjeve apo individëve të cilët janë përfitues në atë program.             |
|  | <b>Banesa sociale me qera të mirëmbajtura</b>                    | Shpenzimet që realizojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për mirëmbajtjen e fondit të banesave sociale të dhëna me qera për familjet në nevojë.   |

# MANUAL MBI PËRFSHIRJEN E TË RINJVE

Projekti:

**“CONNECTED: BUILDING  
BRIDGES, CREATING FUTURES”**

British Council Albania dhe  
Agjencia Kombëtare e Rinisë